




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Telecommunications Regulatory Authority
Regulativni Autoritet Telekomunikacije



Raporti Vjetor (2011)

Raporti vjetor për vitin 2011 për Kuvendin e Republikës së Kosovës
Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri



Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
www.art-ks.org

Prishtinë, 21 Maj, 2012

HYRJE

Autoriteti Rregulator i Telekomunikacionit (ketej e tutje 'ART'), në përputhje dhe zbatim të dispozitës së nenit 13 paragrafi (7) të Ligjit për Telekomunikacionin, Nr. 2002/07 i amandamentuar me Ligjin Nr. 03/L/085 (këtej e tutje 'Ligji'), i paraqet autoritetit të saj themelues, Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin e rregullt vjetor të aktiviteteve për vitin 2011 të shoqëruar me raportin finanziar, për informim, shqyrtim dhe miratim.

Aktivitetet ART-së në 2011 u përqëndruan kryesisht në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike të përcaktuara për rregullimin e shërbimeve telekomunikuese dhe shërbimeve postare me një theks të veçantë në ruajtjen dhe promovimin e konkurrencës efektive dhe të qëndrueshme, në nxitjen e konkurrencës si një parakusht për investime në tregjet e mësipërme, sigurimi i cilësisë së duhur të shërbimeve telekomunikuese dhe postare me çmime të volitshme, si dhe një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit.

Raporti ofron dhe siguron informacione përmbytjesore mbi statusin dhe progresin e angazhimeve të ART-së në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike si të tilla të përcaktuara me ligj dhe dokumentin e politikave të sektorit të telekomunikacionit gjitha këto të transpozuara dhe si të tilla të shpalosura me aktet përkatëse normative (*legislacioni sekondar – aktet rregullatore*).

Raporti gjithashtu përbledh dhe paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e telekomunikimeve dhe shërbimeve postare, si dhe të dhëna thelbësore teknike e komerciale për aktivitetet e rregulluara në tregun e telekomunikimeve dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës.

Viti 2011 ka qenë një vit sfidash për ART në vlerësim dhe këndvështrim të kufizimeve evidente në resurset operacionale por njëkohësisht edhe një vit i mirë për Autoritetin Rregulator të Telekomunikacionit në vlerësim të të arriturave dhe performances së gjithëmbarshme si dhe nga të gjitha pikëpamjet tjera materiale, fal mobilizimit dhe angazhimit në përbushje të detyrimeve të konsideruara me prioritet të lartë.

Si ngjarjet me kryesore me efekte signifikative në sektoret e rregulluara do të përmendnim;

- I. Miratimin e Planit Kombëtar të Shpërndarjes së Spektrit Frekuencor – gjegjësisht të 'Tabelës Kombëtare të Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Frekuencor në Brezin 9 KHz deri 275 GHz' nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës (Ref. Vendimi Nr. 04-V-93 dt. 23/06/2011)

Pas një procesi transparent dhe afatëgjatë të këshillimit dhe shqyrtimit profesional, ART sipas aktvendimit të Bordit (Ref. Vendimi Nr.62, Nr. Prot. 006/B/11) përmbylli procesin kapital përpilimin për herë të parë të shtetit të Kosovës nga ekspertët vendor dhe me resurse vetanake të Planit (tabelës) Kombëtare e cila përpilohet me qëllim të sigurimit të përdorimit efektiv dhe efikas të resurseve frekuencore të përcaktuara me ligj si resurse të kufizuara.

Plani kombëtar me tabelën e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të spektrit frekuencor është në tërësi i harmonizuar me rekomandimet, vendimet dhe standarde ndërkombëtare që kanë te bëjnë me shfrytëzimin e resurseve natyrore - frekuencave si të tilla të miratuara me rekomandimet dhe raportet e CEPT/KE, radio rregulloret e ITU-së dhe standarde miratuara nga ETSI; përfshi këtu koordinimim e ngushtë me misionin e KFOR-it (si administrator i përkohshëm i brezit militar frekuencor) dhe palët tjera të interesit (si KPM, operatorët, etj).

- II. Dhënen e autorizimit individual për të drejtën e përdorimit (shfrytëzimit) të radio spektrit frekuencor 2x10 MHz në brezin 1800 MHz për shërbime telekomunikuese mobile në tërë territorin e Republikës së Kosovës për nevoja te operatorit PTK sh.a/Vala.

Pas një procesi transparent dhe afatëgjatë të shqyrtimit, këshillimit me grupet e interesit, bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, pas miratimit të rekomandimit nga ana e QeK për përcaktimin e çmimit minimal (pragut) për brezin e ndarë (2x10 MHz në brezin 1800) në lartësi prej 14,180,906.00 €, ART përmes aktvendimeve Nr. 134 dhe Nr. 135 ka autorizuar lejimin e përdorimit të brezit frekuencor të ndarë me fillim nga 1 Janari, 2012 dhe ka amandamentuar licencën bazë të operatorit, PTK Sh.a/Vala Nr. 111/04 duke e plotësuar atë me shtojcën e cila specifikon kanalet e dhëna në përdorim.

Kjo ndarje e brezit frekuencor i mundëson operatorit të zhvillojë konkurrencë fer në mënyrë të papenguar duke i mundësuar ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve kualitative telekomunikuese.

- III. Ngritjen dhe funksionalizimin e plotë të nyjës së parë kombëtare shkëmbyeze të internetit (e njojur si KOSIX www.kosix.net) arritje kjo e publikuar në revistën e muajit Maj 2012, të publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Iniciativës Elektronike të Evropës Juglindore 'eSEE Agenda +'

Projekti për ngritjen e nyjës shkëmbyeze të internetit është realizuar në koordinim dhe me përkrahje teknike dhe bashkëfinancim nga Qeveria Norvegjeze respektivisht Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, programin e KPEP-it të USAID-it si dhe korporatës multinacionale CISCO e cila ka dhuruar si donacion shumicën e pajisjeve të nevojshme për funksionimin teknik të nyjës. Funksioni dhe qëllimi i KOSIX është ndërlidhja e ofruesve të shërbimeve të internetit (ISP) në mes vete dhe mbajtjen e trafikut lokal të internetit brenda kufijve vendor.

- IV. Inkasimin e të hyrave vetanake në lartësi prej 18,043,502.89 € që paraqet tejkalim të planit të të hyrave të projektuara në lartësi prej 13.2%.
- V. Funksionalizimi i sektorit të shërbimeve postare dhe fillimin e rregullimit të sektorit postar në Republikën e Kosovës
- VI. Permbyllja e procesit të analizes së tregut - segmenti i telefonisë fiksë
- VII. Realizimin e dy projekteve të rëndësisë strategjike; ngritjen e platformës - sistemit të integruar informativ gjeografik Web GIS për nevoja të ART-së si dhe ngritjen e platformës, gjegjësisht bazës së të dhënavë statistikore për administrimin e të dhënavë të grumbulluara nga operatorët në/nga procesi i Analizës së Tregut.
- VIII. Dhënien e kontributit profesional teknik në dhe gjatë procesit të dialogut teknik në referim të temës së telekomunikacionit.
- IX. Angazhimin permanent në dhënien e kontributit në grupet punuese për dhe gjatë hartimit të Projektligjit për Komunikime Elektronike, Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ligjit për Shërbimet e Shoqërisë Informatike.

Gjatë gjithë vitit 2011, është vazhduar së punuari në kompletimin dhe sigurimin e kuadrit të nevojshëm rregullator të sektorit që inkurajon investimet në sektor dhe jep garanci per konkurrence efektive dhe përfitime për konsumatorin. Zbatimi me standarde të avancuara të transparencës, konsistенca dhe uniformiteti i interpretimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të hartuar nga ART ka kontribuar ndjeshëm në sigurimin e parametrit dhe kushtit të rëndësishëm të qartësisë

dhe pavarësisë rregullatore, çka dokumentohet edhe me përmirësimin e klimës së per gjithshme të favorshme per investime e cila solli rritjen e interesit të subjekteve të reja për të hyr në tregun e telekomunikimeve.

Mbështetur në adoptimin e procedurave të lehtësuara, reduktimin e barrierave administrative, shkurtimin e afateve të trajtimit të aplikacioneve, intesifikimin e aktiviteteve monitoruese dhe mbikëqyrëse të tregut si dhe pjesërisht edhe mbështetur në reduktimin e tarifave hyrëse të licencimit, gjitha këto objektiva të promovuara edhe me agjendën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, numri i operatorëve të rinj të licencuar për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese kryesisht atyre me vlerë të shtuar dhe shërbimeve të internetit vetëm gjatë vitit 2011 është 38, ndërsa totali i operatorëve të licencuar në fund të vitit 2011 ishte 86 në krahasim me 48 në fund të vitit 2010.

Menaxhimi dhe dhënia në përdorim e resurseve të kufizuara publike, spektrit të radio frekuencave dhe numeracionit, janë me interes për Republikën e Kosovës. Si një autoriteti nacional rregullator, ART është e ngarkuar me detyrën e nxitjes së konkurrencës në fushën e telekomunikimeve dhe menaxhimin efikas të këtyre burimeve të kufizuara.

Menaxhimi me efikasitet, ka rezultuar që numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të resurseve frekuencore dhe resurseve numerike të arrij në;

- 244 licenca për përdorim të resurseve/kanaleve frekuencore që krahasuar me vitin 2010 është për 66% më i lartë
- si dhe përcaktimin (ndarjen) e gjithsej 67 numrave jo-gjeografik të ndara përmes 41 vendimeve që krahasuar me vitin 2010 (*vetëm 4 vendime për përcaktimin/ndarjen e 4 numrave jo-gjeografik*) është shumëfish më i lartë.

Gjitha masat dhe angazhimet e mësipërme përfshi këtu edhe ndalimin dhe kufizimin e operimit të operatorëve ilegal në Republikën e Kosovës kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e të hyrave (ardhurave) të përgjithshme të operatorëve të licencuar nga shërbimet telekomunikuese, që gjatë vitit raportues ka arritë totalin prej mbi 238 milion euro apo 7% më shumë se në vitin 2010 dhe/apo mbi 12% më shumë nëse krahasuar me vitin 2009. Kjo rritje e përgjithshme e të hyrave ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në rritjen e të hyrave buxhetore të shtetit si dhe më së miri dokumenton potencialin zhvillimor dhe atraktivitetin për investorët potencial vendor dhe ndërkombëtar duke nënkuptuar këtu edhe atraktivitetin dhe potencialin e promovuar nga Qeveria e Kosovës në referim të procesit kapital për ndërrimin e strukturës së aksionarëve, përmes privatizimit të operatorit publik.

Nëse shikuar sipas segmenteve të tregut, vërejmë se;

- Segmenti i telefonisë mobile ka shënuar rritje prej rreth 9.94% apo shprehur në vlera nominale me rreth 199.2 mil € gjatë vitit 2011 krahasuar me diq më shumë se 181 mil € të regjistruara në vitin 2010;
- Segmenti i telefonisë fikse ka shënuar rritje prej 0.67% apo shprehur në vlera nominale me mbi 20.04 mil € gjatë vitit 2011 krahasuar me 20.026 mnl € të regjistruara në vitin 2010;
- Segmenti i Internetit ka shënuar rënje prej mbi 4.93% apo shprehur në vlera nominale të hyrat e shërbimeve të internetit sillen rreth 18.6 mil € gjatë vitit 2011 krahasuar me mbi 19.5 mil € të regjistruara në vitin 2010;
- Segmenti i tregut të Shërbimeve Postare, rezulton në totalin e tij rezulton të jetë me rreth 3.3 mnl €. Të dhënët për tregun e shërbimeve postare, paraqiten për herë të parë nga ART si detyrim i dal pas hyrjes në fuqi të Ligit Nr. 03/L-173 mbi monitorimin dhe rregullimin nga ART të tregut të shërbimeve postare.

ART përgjatë vitit raportues në përbushje të detyrimeve për përafrimin e praktikave rregullatore me ato të autoriteteve homologe të shteteve të Bashkimit Evropian dhe shteteve të rajonit në kuadër të programit të Komisionit Evropian për monitorimin e tregjeve të komunikimeve elektronike, të implementuar nga Cullen International, ka vazhduar të jap dhe paraqes kontributin e saj përmes raportimeve të rregullta që më pastaj si të tilla edhe bëhen pjesë integrale e raportit të progresit të Komisionit Evropian, por mes tjerash edhe të monitorojë zhvillimet e përgjithshme në nivel European me qëllimin e dhënies së kontributit për amendamentimin e legjislacionit primar dhe sekondar që duhet të marrin në konsideratë vendimet e fundit (Dhjetor 2009) të Bashkimit European për kuadrin rregulator për sektorin e komunikimeve elektronike.

Interesat e qytetarëve dhe konsumatorëve, krijimi i kushteve për operim pa-interferenca nga operimet e pa-autorizuara si dhe ushtrimi i mandatit të mbikëqyrjes efektive të operimit konform kushteve të autorizimeve dhe licencave përfshi këtu edhe zgjidhjen e konflikteve mes operatorëve të licencuar dhe/apo mes operatorëve dhe konsumatorëve, përgjatë vitit raportues kanë qenë në qendër të qëllimeve dhe në fokus të angazhimeve të ART-së, çka edhe ilustrohet më së miri në pjesën e të arriturave kryesore gjatë vitit raportues.

Misioni i përcaktuar i të qenurit një rregulator i pavarur dhe pararendës për tregjet e telekomunikimeve dhe shërbimeve postare duke u angazhuar në arritjen dhe zbatimin e kuadrit rregulator që nxit një mjesid të favorshëm për investitorët dhe ofron zgjidhje, çmime dhe cilësi më të mirë për të gjithë, vlerësohet që gjatë vitit 2011 të jetë përbushur si asnëherë deri më tanë. Rrjedhimisht, përmes nxitjes së konkurrencës dhe mbrojtjes së interesit të qytetarëve në cilësinë e konsumatorëve të shërbimeve telekomunikuese dhe postare, ka filluar të jap përfitime të prekshme si; çmime kompetitive dhe më të ulta, më shumë zgjedhje, shërbime të reja dhe prezantim (futje) në treg të teknologjive nga ato më të fundit.

Nisur nga rrethanat e njoitura ku sektori i komunikimeve elektronike karakterizohet nga dinamika e lartë e ndryshimeve dhe inovacionit, detyron ART si rregulator nacional që në vazhdimësi të përgatitet për tu përballuar me sfidat e reja me të cilat dhe do të ballafaqohet edhe më shumë në një të ardhme të afërt, kryesisht menduar këtu në konvergjencen dixhitale të telekomunikacioneve dhe transmetimeve radio-televizive.

Në përbushje të qëllimeve dhe objektivave si më sipër të paraqitura edhe gjatë vitit 2011, ART fal konsolidimit dhe pjekurisë menaxheriale dhe organizative ka vazhduar të pranoj asistencë domethënëse teknike përmes mekanizmit të TAIEX-it, asistencë kjo me rëndësi kruciale në rrumbullakimin e kornizës rregullatore (legjislacionit sekondar), në avancimin e komptencës dhe përvojes rregullatore përmes punës dhe angazhimeve të përbashkëta në gjitha fazat kryesore të administrimit dhe nxjerrjes së akteve normative rregullatore si dhe me efekt të drejtëpërdrejt edhe në menaxhimin efektiv të buxhetit përmes ndikimit të drejtëpërdrejt në kursimet buxhetore në kategorinë e mallërave dhe shërbimeve (*Kat. Shërbimet e kontraktuara 13400*).

Andaj, për të gjitha të arriturat në emër timin dhe në emër të Bordit të ART-së, dua t'i falënderoj të gjithë kolegët anëtar të bordit, në veqanti stafin profesional njëkohësisht zyrtar drejtues në nivel departamentesh dhe sektorëve të ART-së me bashkëpunëtorët e tyre profesional dhe stafin administrativ të ART-së, si dhe të gjitha ato institucione e individë që, në çfarëdo mënyre na kanë ndihmuar në kryerjen me sukses të punëve dhe të detyrave tona.

Në vazhdim më lejoni t'Ju paraqes Raportin Vjetor, i cili ngërthen dhe përbledhje të aktiviteteve, ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme të ndodhura në sektorin e

telekomunikimeve dhe shërbimeve postare gjatë 2011, duke ju siguruar në vazhdimësinë e angazhimeve të ART-së për kontinuitet në arritje.

Sinqerisht,

Ekrem HOXHA



PËRMBAJTJA

HYRJE	2
PËRMBAJTJA.....	7
PËRMBLEDHJE E TË ARRITURAVE STRATEGJIKE.....	9
SFIDAT KRYESORE ME TË CILAT ËSHTË / DHE VAZHDON TË BALLAFQOHET ART-JA;	12
NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR AUTORITETIN RREGULATOR TË TELEKOMUNIKACIONIT DHE SHËRBIMEVE POSTARE.....	13
<i>MANDATI I AUTORITETIT RREGULATOR TË TELEKOMUNIKACIONIT.....</i>	<i>13</i>
<i>STRUKTURA ORGANIZATIVE E ART-SË.....</i>	<i>14</i>
<i>BORDI.....</i>	<i>14</i>
DEPARTAMENTET.....	15
<i>Departamenti i Telekomunikacionit</i>	<i>15</i>
<i>Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave.....</i>	<i>15</i>
SEKTORËT (ZYRAT)	16
<i>Sektori i Radio-monitorimit të spektrit radio-frekuencor.....</i>	<i>16</i>
<i>Sektori i Shërbimit Postar.....</i>	<i>16</i>
<i>Zyra Ligjore</i>	<i>17</i>
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS	17
<i>Ngritura e kapaciteteve të ART-së - projektet e asistencës teknike, kurset dhe trajnimet</i>	<i>17</i>
<i>Projektet e Asistencës Teknike</i>	<i>17</i>
RAPORTI FINANCIAR	19
<i>TË HYRAT</i>	<i>19</i>
<i>BUXHETI.....</i>	<i>19</i>
AKTIVITETI RREGULATOR GJATË VITIT 2011	21
<i>RREGULLORET;.....</i>	<i>21</i>
<i>VENDIMET/ URDHËRESAT ADMINISTRATIVE.....</i>	<i>23</i>
<i>LICENCIMET.....</i>	<i>24</i>
PASQYRË E PËRGJITHSHME E TREGUT TË TELEKOMUNIKEVE	26
<i>PASQYRA E TË ARDHURAVE NGA SHËRBIMET TELEKOMUNIKUESE</i>	<i>29</i>
<i>INVESTIMET E BËRA NË RRJETE DHE SHËRBIME TELEKOMUNIKUESE</i>	<i>30</i>
TELEFONIA FIKSE.....	31
<i>NUMRI PËRDORUESVE TË TELEFONISË FIKSE.....</i>	<i>31</i>
<i>NDARJA E TREGUT</i>	<i>32</i>
<i>TRAFIKU I TELEFONISË FIKSE</i>	<i>33</i>
<i>STRUKTURA E THIRRJEVE NË TELEFONINË FIKSE</i>	<i>34</i>
<i>TEKNOLOGJA E PËRDORUR NGA OPERATORËT E LIÇENSUAR.....</i>	<i>35</i>
<i>TARIFAT LOKALE DHE NACIONALE</i>	<i>35</i>
TELEFONIA MOBILE	36
<i>PËRDORUESIT E TELEFONISË MOBILE</i>	<i>36</i>
<i>NDARJA E TREGUT SIPAS PËRDORUESVE</i>	<i>38</i>
<i>TË ARDHURAT E TELEFONISË MOBILE.....</i>	<i>38</i>

STRUKTURA E PËRDORUESVE TË TELEFONISË MOBILE	39
TRAFIKU TELEFONIK	40
TARIFAT	47
TARIFAT E THIRRJEVE KOMBËTARE	49
TARIFAT E THIRRJEVE NDËRKOMBËTARE	50
TARIFAT E PËR SMS	50
TARIFAT E ROAMINGUT	51
TARIFAT E TERMINIMIT	51
MBULUESHMËRIA DHE ELEMENTET E RRJETIT	54
INTERNETI	54
NUMRI I PËRDORUESVE ME QASJE BREZ GJERE	54
NDARJA E TREGUT	56
TEKNOLOGJITË E PËRDORURA	56
PËRDORUESIT SIPAS OPERATORËVE (ISP)	58
TARIFAT	60
LINJAT ME QIRA	61
PASQYRË E PËRGJITHSHME MBI TREGUN POSTAR	62
VEPRIMTARIA JURIDIKE E ART-SË NË RREGULLIM	66
VEPRIMTARIA INSPEKTUESE DHE MONITORUESE	68
VEPRIMTARIA INSPEKTUESE	68
VEPRIMTARIA MONITORUESE	68
LLOGARIDHËNIA E ART-SË	70
SIGURIMI I INTEGRITETIT	70
DEKLARATA PËR TRANSPARENCE	70
ANEKS A	71
ANEKS B	74
ANEKS C	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
ANEKSI D	75
ANEKSI E	82

PËRMBLEDHJE E TË ARRITURAVE STRATEGJIKE

ART ka zhvilluar aktivitetet e saja bazuar në objektivat dhe veprimet e përkufizuara me Planin e Punës për vitin 2011, të miratuar nga Bordi i ART-së, duke i zbatuar detyrimet dhe arritur shumicën e objektivave të parapara si dhe tejkaluar ato në rastet kur përmbushja e tyre është varur në tërësi nga mandati i ART-së.

Shënimet në vijim paraqesin në formë të përmbledhur të dhënat e kërkua sipas ligjit për raportim përfshi këtu të arriturat kryesore që janë regjistruar gjatë vitit raportues, 2011.

- 1) **13** mbledhje të rregulla të autoritetit ligjor, Bordit të ART-së
 - ✚ krahasuar me **15** mbledhje të administruara gjatë vitit 2010
- 2) **6** rregullore të aprovuara dhe fuqizuara
- 3) **1** amandamentim / plotësim i rregulloreve në fuqi
 - ✚ krahasuar me **5** rregullore të aprovuara gjatë vitit 2010 dhe
 - ✚ **2** amandamente / plotësime të rregulloreve në fuqi gjatë vitit 2010:
- 4) **10** këshillime publike të administruara
 - ✚ krahasuar me **6** këshillime publike të administruara gjatë vitit 2010
- 5) **106** aktvendime të ndryshme me karakter rregulator dhe administrativ,
 - ✚ krahasuar me **52** aktvendime të nxjerra gjatë vitit 2010
- 6) **3** udhëzues mbi procedurat e administruara nga ART respektivisht ndërlidhur me;
 - *Procedurat e këshillimit publik me palët e interesit*
 - *Procedurat mbi procedurat e udhëhequra në menaxhimin e resurseve frekuencore si dhe*
 - *Udhëzuesin mbi të drejtat e përdoruesëve fundor (konsumatorëve)*
 - ✚ krahasuar me **1** udhëzues të nxjerr gjatë vitit 2010
- 7) Administruar **3** procese mbi/për zgjidhjen e konfliktave dhe arbitrimit mes operatorëve të licencuar duke zgjidhur **1** prej tyre sipas aktvendimit përkatëse dhe **2** prej tyre duke e mbyllur trajtimin e tyre kundrejt memove sqaruese/rekomanduese drejtuar palëve të përfshira në procedurë
 - ✚ krahasuar me **2** procedura të iniciuara gjatë vitit 2010
- 8) Marrë në shqyrtim **5** raste të ankesave të qytetarëve /konsumatorëve duke i përmbyllur dhe zgjidhur ato pëmes memove sqaruese/rekomanduese ndaj operatorëve;
- 9) Realizuar **2** projekte kapitale me rëndësi për zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit dhe krijimin e kushteve për promovim të investimeve në sektor të telekomunikacionit, inkurajim të konkurrencës dhe monitorim efikas të resurseve infrastrukturore njëkohësisht duke avancuar ndjeshëm bazueshmërinë dhe faktografinë e vendimeve dhe interpretimeve rregullatore
- 10) Përfituar nga **katër (4)** projekte të asistencës teknike direkte nga Komisioni Evropian përmes instrumentit/Programit TAIEX në kohëzgjatje prej 20 ditë pune dhe gjithsej **5** ekspertëve senior të ardhur nga rregulatorët e shteteve të BE-së.

↳ kahasuar me 6 projekte të ngjashme të realizuara gjatë vitit 2010

11) Përfituar asistencë financiare nga donatorët, Qeveria Norvegjeze përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme në lartësi prej 50,000.00 €, CISCO International B.V. në pajisje teknologjike/harduerike dhe softuerike në vlerë prej rreth 40,000.00 € dhe USAID/KPEP pajisje suportuese në vlerë prej rreth 7,000.00 € për ta realizuar fazën kryesore të projektit kapital përgritjen dhe funksionalizimin e Nyjës Shkëmbyese të Internetit (KOSIX)

↳ kahasuar me asnjë projekt të ngjashëm të realizuar / përfituar gjatë gjithë mandatit të Bordit paraprijës 2004 - 2009

12) Nënshkruar dy (2) Marrëveshje Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi, një me autoritetin rregullator homolog nga Republika e Kroacisë dhe një me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës në adresim të rekomandimit të dal me Raportin e Progresit për vitin 2010.

13) Shqiptuar 6 dënlime/gjoba administrative, në vlerë prej **35,039.25 €**

↳ kahasuar me 4 dënlime /gjoba të shqiptuara gjatë vitit 2010 dhe **159,000.00 €** të inkasuara

14) Inkasuar të hyra në vlerë totale prej **18,043,502.89 €**

↳ kahasuar me **9,558,542.69 €** të hyra, gjatë vitit 2010

Prej të cilave të ndara sipas kategorive të të hyrave;

- **14,257,406.00 €** të hyra nga licencat
- **2,672,181.20 €** të hyra nga shfrytëzimi i resurseve frekuencore
- **424,200.00 €** të hyra nga shfrytëzimi i resurseve te numeracionit
- **651,976.34 €** të hyra nga tarifa vjetore
- **35,039.25 €** të hyra nga shqiptimi i masave sankzionuese
- **2,700.00 €** të hyra nga sherbimet administrative

15) Vazhduar me avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit profesional dhe administrativ për të siguruar punë efektive dhe me efikasitet më të lartë duke mbajtur në fokus angazhimin drejt ndërtimit të një kuadri me staf professional dhe të përgjegjshëm.

- **176 ditë trajnimi** në total të kontraktuara /realizuara gjatë vitit 2011;

Vlen të potencohej se ruajtja dhe ndërtimi i kuadrit rregulator, si kuadër deficitar në tregjet e punës kërkon pjesëmarje dhe llogaridhënie aktive të brendshme përfshi këtu ofrimin dhe krijimin e parakushteve për stafin që të zhvillohet dhe avancohet në kompetencat e tija/saja me kalimin e kohës. Gjatë vitit raportues si edhe në vitin paraprijës, menaxhmenti është përkujdesur në planifikimin e aktiviteteve dhe vendosjen e procedurave të standardizuara e transparente dhe marrjen e një sërë masash për të lehtësuar dhe facilituar një proces të tillë jo edhe të lehtë marrë në konsiderate diversitetin e profileve të stafit dhe ambicieve për zhvillim në karrier mes tjerash edhe permes ngritjes së bibliotekës profesionale me rreth 100 libra profesional.

Në aspektin e avancimit të transparencës gjatë vitit 2011, ART ka vazhduar me përpikëri dhe konsistencë ta përbush obligimin e saj ndërlidhur me publicitetin e punëve dhe angazhimeve të

kryera. Gjitha informacionet dhe dokumentet relevante mbi aktivitetet e ART-së rregullisht dhe në kohë reale janë publikuar në ueb faqën e ART-së përshi këtu;

- publikimin e gjitha akteve rregullatore dhe vendimeve me efekt rregulator të miratuara nga Bordi Drejtues përfshi këtu edhe vendimet administrative me efekt për palët e treta;
- zhvillimin e procedurave mbi këshillimet publike si të parapara me nenin 10 të Ligjit për Telekomunikacionin, dhe organizuar dhe mbajtur debate publike mbi gjitha çështjet me rëndësi për palët e interesit;
- publikimin dhe azhornimin e rregulltë të databazave gjegjësisht regjistrave të operatorëve, ofruesve të shërbimeve telekomunikuese, operatorëve të shërbimeve postare dhe shërbimeve korrier, si dhe shfrytëzuesve të autorizuar të resurseve/kanaleve frekuencore dhe numerike.
- publikimin e rregullt të raporteve periodike me të dhënat statistikore të tregjeve të telekomunikimeve;
- publikimin e rregullt të të dhënavëve dhe informacioneve të menduara dhe drejtuara për shfrytëzuesit e fundëm (konsumatorët) e shërbimeve telekomunikuese dhe shërbimeve postare;
- lansuar ueb faqën e nyjes shkëmbyese të internetit www.kosix.net;
- konsoliduar dhe përmbyllur procesin e vlerësimit individual të performancës për çdo zyrtar të ART-së për vitin 2011.

Në përkrahje të informacioneve të publikuara në ueb faqën e autoritetit, zyrtarët drejtues të ART-së janë paraqitur në emisione të ndryshme të radios dhe televizioneve dhe përmes komunikatave për shtyp, ku në mënyrë plotësuese kanë informuar audiencën e gjerë mbi gjitha çështjet e vlerësuara me rëndësi për dhe mbi lëminë e telekomunikacionit dhe sektorit postar.

Për më shumë, ART gjithashtu në mënyrë të rregulltë dhe brenda afatave më të shkurtëra kohore të mundshme iu është përgjigjur gjitha pyetjeve të parashtuara nga gazetarët dhe gjitha pyetjeve tjera të ardhura nga palët e interesuara, si qytetarët, përfaqësues të investitorëve apo furnizuesëve të tregut të telekomunikimeve. Gjithsesi, në referim të përmbrushjes së obligimeve për transparencë, vlen të theksohet se në mungesë të resurseve njerëzore dhe profesionale, gjatë vitit 2011 ART ka vazhduar të përballet me sfidën administrative, ndërlidhur me obligimin për publikimin e dokumenteve edhe në gjuhën serbe dhe atë angleze.

SFIDAT KRYESORE ME TË CILAT ËSHTË / DHE VAZHDON TË BALLAFAQOHET ART-ja;

A) Sfidat e Përgjithshme

- Pa-mundësia e adresimit efektiv të nevojës permanente për rritjen e kapaciteteve dhe resurseve profesionale gjegjësht shtimit të numrit të stafit profesional dhe qartësimin e statusit ligjor të stafit profesional të ART-së, duke mos i trajtuar ata si shërbyses civil;

Kapacitetet aktuale të autoritetit janë të kufizuara dhe jo-proporcionale me nevojat dhe obligimet e dala nga ligjet burimore si dhe në krahasim me vëllimin e angazhimeve të raportuara si dhe në veqanti në referim të kërkesave në rritje të dala nga vetëdijësimi në rritje i konsumatorëve për dhe mbi të drejtat e tyre si dhe rritja e konkurrencës efektive në treg dhe konvergjencën teknologjike e cila implikon edhe nxjerren dhe adoptimin e kornizës rregullatore adapte me rritmet e zhvillimit të tregut.

- Hapësira e kufizuar dhe infrastruktura jo adekuate për ushtrimin e mandatit rregulator;

B) Sfidat Specifike

- Vazhdimi i operimit të operatorëve ilegal mobil në pjesën veriore të Republikës së Kosovës;
- Infrastruktura e rrjetit, telefonisë fikse dhe infrastruktura kabllore, fibrit optik të operatorit, Telekom Serbia në zonat e banuara me/nga komuniteti etnik Serb;
- Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve /dërgesave postare në zonat e banuara me/nga komuniteti etnik Serb,
- Vazhdimi i kontradiktave në interpretim të dispozitave të ligjit të telekomunikacionit dhe rregulloreve të ART-së nga disa institucione dhe autoritete/organizata vendore dhe ndërkombëtare (*Referencë; kualifikimi si kategori përjashtuese (përfituese) në shfrytëzim të resurseve të fundme /frekuencave*)

NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR AUTORITETIN RREGULATOR TË TELEKOMUNIKACIONIT DHE SHËRBIMEVE POSTARE

Mandati i Autoritetit Rregulator të Telekomunikacionit

Autoriteti Rregulator i Telekomunikacionit (ART), sipas nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është themeluar si institucion i pavarur nga Kuvendi i Kosovës, që të ushtroj dhe kryen rregullimin ekonomik në sektorin e telekomunikimeve dhe shërbimeve postare, në pajtim me Ligjin për Telekomunikacionit, Nr. 2002/07, Ligji ky i amandamentuar me Ligjin Nr. 03/L-085 si dhe Ligjin për Shërbimet Postare, Nr. 03/L-173.

ART është autoriteti nacional rregulator në fushën e telekomunikimeve dhe atë të shërbimit postar, i cili zbaton dhe mbikëqyr kuadrin rregulator të përcaktuar me ligjin për telekomunikacion dhe nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit të sektorit të telekomunikimeve si të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

ART është person juridik, publik, jo-fitimprurës¹, i cili udhëhiqet dhe drejtohet nga Bordi Drejtues që është njëkohësisht autoriteti ligjor dhe i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vet. Udhëheqësi i Bordit Drejtues është njokësisht edhe drejtues ekzekutiv i ART-së.

Mandati dhe detyrat kryesore të ART-së janë që të siguroj dhe krijoj kushte për ofrim të shërbimeve telekomunikuese dhe shërbimeve postare ndaj konsumatorëve me cilësi dhe kualitet të garantuar konform termeve dhe standardeve të përcaktuara me ligj, rregulloret dhe licencat përkatëse të ndara për operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të licencuara, të ndërtoj dhe siguroj një treg konkurrues të shërbimeve telekomunikuese dhe postare në Kosovë që do të bazohet mbi parimet e objektivitetit, transparencës dhe mos-diskriminimit.

Përgjegjësitetë specifike të ART-së janë të përcaktuara me ligjin e telekomunikacionit dhe ligjin për shërbimet postare dhe mandati i saj ushtronhet përmes; lëshimit, modifikimit, tërheqjes, monitorimit të licencave për aktivitetet e ofrueseve të shërbimeve telekomunikuese, nxjerrjes së legislacionit dytësor, monitorimit të ndarjes efektive të resurseve fundore si spektri frekuencor dhe serive numerike, zhvillimit të konkurrencës, si dhe zgjidhjes së kontesteve në mes të licencuarve e konsumatorëve.

Më saktësisht si përcaktuar me ligjin në fuqi, ART është përgjegjëse;

- ✚ licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të telekomunikacionit dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës;
- ✚ inkurajimin e sektorit privat që të hyj në tregun e telekomunikacionit dhe shërbimeve postare;
- ✚ promovimin dhe mbështetjen e plotë të konkurrencës së drejtë në përputhje me dispozitat në fuqi;
- ✚ rregullimin dhe aplikimin e standardeve unike për të gjithë ofruesit e shërbimeve telekomunikuese dhe shërbimeve postare;
- ✚ zhvillimin e politikes jo diskriminuese ndaj të gjithë atyre që dëshirojnë të hyjnë në këto tregje; dhe
- ✚ mbrojtjen maksimale të mundshme të konsumatoreve që përdorin shërbimet e ofruara telekomunikuese dhe ato postare.

¹ Organizatë jo-buxhetore

ART është dhe angazhohet që të veproj duke respektuar provisionet e ligjit te telekomunikacionit, ligjit të shërbimeve postare dhe objektivave të politikave të sektorit, duke u përkujdesur në përmbushjen e afateve kohore dhe sigurimit të zhvillimit të pa-penguar të tregut të telekomunikimeve dhe postare në Republikën e Kosovës në mënyrë dhe me objektiv plotësimin e kushteve dhe krijimin e para-kushtet të mëposhtme rregulative;

- ✚ krijimin e një tregu të lirë dhe të hapur, ku gjithë pjesëmarrëseve u garantohet trajtim i barabartë;
- ✚ koordinimin e aktiviteteve të të gjithë pjesëmarrësve të tregut të telekomunikacionit me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e shoqërisë informative;
- ✚ vendosjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve telekomunikuese në plan të parë;
- ✚ përdorimin racional dhe efikas të të gjitha resurseve të kufizuara (frekuencave dhe numeracionit);
- ✚ harmonizimin e rregulloreve, standardeve, dispozitave teknike dhe praktike me rregulloret aktuale relevante te B.E;
- ✚ inkurajimin e shërbimeve universale (USO) dhe ofrimin e shërbimeve telekomunikuese për të gjithë qytetaret e Republikës se Kosovës;
- ✚ krijimin dhe vendosjen e masave mbrojtëse për të siguruar krijimin e një ambienti plotësisht konkurrues për të gjithë ofruesit e shërbimeve telekomunikuese.

Krijimi i parakushteve për konkurrencë efektive të zhvilluar në treg të liberalizuar dhe të rregulluar të telekomunikimeve siq edhe potencuar në hyrje të këtij raporti ka mundësuar një zhvillim deri në një masë të pa-penguar të tregut, duke rezultuar me rritje konstante të të ardhurave të mbledhura nga shërbimet e sektorit të telekomunikacionit dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës, që gjatë viti 2011 në shënimet e ART-së rezulton të janë mbi 240 milion euro.

Struktura Organizative e ART-së

Kompetencat dhe detyrat e Bordit Drejtues të ART-së janë të përcaktuara me Ligj dhe përmë tutje të specifikuara me Rregulloren e Brendshme të ART-së.

ART në strukturën e saj aktuale përvçe Bordit Drejtues të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, ka tre departamente kryesore, dy sektorë dhe dy zyra.

BORDI

Bordi përbëhet nga pesë anëtarë, përfshirë edhe kryesuesin e Bordit, i cili njëkohësisht është edhe udhëheqës ekzekutiv i ART-së. Kuvendi i Kosovës, në Shtator 2009, ka bërë emërimin e anëtarëve të rinj të bordit, kështu që me fillim nga 1 Tetori i viti 2009, Bordi ka qenë i kompletuar dhe plotësisht funksional.

Bordi për aktivitetet e ART-së dhe për zhvillimet në sektorin e telekomunikacionit, i raporton Kuvendit të Kosovës dhe komisioneve funksionale të tij, sipas kërkesës së tyre, përmes kontakteve dhe njoftimeve të kohëpaskohshme dhe në veqanti përmes raportit vjetor.

Bordi i përmbush detyrat e tij në përputhje me detyrat e përgjegjësítë që i janë dhënë dhe përcaktuar me Ligj.

Gjatë vitit 2011 Bordi ka mbajtur gjithsej 13 mbledhje të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar çështje të ndryshme në/dhe ndërlidhur me rregullimin e sektorit të telekomunikacionit dhe shërbimeve postare me që rast edhe ka administruar gjegjësish nxjerr 106 vendime, nga të cilave 52 prej tyre me karakter dhe efekt rregulator dhe si të tilla gjitha të bëra publike ndaj palëve të interesit dhe ato me interes të përgjithshëm të publikuara në faqen elektronike të ART-së (<http://www.art-ks.org/?cid=1,26>).

DEPARTAMENTET

Departamenti i Telekomunikacionit

Departamenti i Telekomunikacionit (D.T) i siguron autoritetit ligjor, Bordit Drejtues mbështetje profesionale në/përmes adresimit të çështjeve të mëposhtme;

- ✚ merr në shqyrtim aplikacionet e pranuara për licencim nga aplikuesit/investitorët e rindër;
- ✚ paraqet rekomandimet lidhur me aplikacionet e shqyrtuara për vëmendje të autoritetit ligjor; bordit dhe nëse e nevojshme për trajtim të mëtutjeshëm në rastet e aplikacioneve që kërkojnë angazhim të resurseve fundore përcjell dosjen me rekomandime për vëmendje të Komisionit Funksional për Licencim, Autorizim dhe Monitorim si komision funksional brenda ART-së;
- ✚ mbikëqyr dhe monitoron aktivitetet e operatoreve të licencuar-a;
- ✚ implementon rregulloret dhe vendimet e aprovuara nga bordi në domenin e sektorit të telekomunikimeve;
- ✚ vlerëson dhe analizon të dhënrat e sektorit të telekomunikimeve dhe publikon raportet me të dhënrat statistikore;
- ✚ analizon ndikimin e faktorëve të ndryshëm si; interkoneksioni, tarifat e terminimeve, qasjen në infrastrukturën esenciale;
- ✚ rekomandon ndarjen (alokimin) e resurseve numerike ne mënyrë jo-diskriminuese dhe transparente për të gjithë operatoret/ofruesit e shërbimeve telekomunikuese dhe përdoruesit tjerë;
- ✚ propozon masa rregulatorë për rregullimin e ngcjeve në treg, me qellim të promovimit të konkurrencës, produkteve dhe shërbimeve të reja në treg dhe mbrojtjen e konsumatorit;
- ✚ zhvillon analizën e tregjeve relevante në sektorin e telekomunikacionit, dhe paraqet rekomandimet për vëmendje të Bordit Drejtues masat/obligimet e propozuara për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT)

Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave

Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave (D.M.F) i siguron autoritetit ligjor, Bordit Drejtues mbështetje profesionale në/përmes adresimit të çështjeve të mëposhtme;

- ✚ planifikimit të shfrytëzimit të resurseve frekuencore në Republikën e Kosovës në konformitet me Planin (Tabelën) Kombëtar të Shfrytëzimit të resurseve radio-frekuencore;
- ✚ hartimin e planit të përdorimit të resurseve frekuencore;
- ✚ rekomandon ndarjen (alokimin) e resurseve frekuencore në mënyrë jo-diskriminuese dhe transparente;
- ✚ hartimin e marrëveshjeve teknike me rregulatorët/agjensionet e telekomunikacionit të shteteve fqinje mbi shfrytëzimin e radio-frekuencave nga operatoret në zonat kufitare si dhe mbikëqyrjen në/gjatë implementimit të tyre;
- ✚ shqyrtimin e aplikacioneve dhe kushteve për licencimin e shfrytëzuesve të spektrit radio-frekuencor;
- ✚ përgatitë dhe implementon rregulloret e aprovuara nga Bordi Drejtues në domenin e menaxhimit dhe shfrytëzimit të spektrit frekuencor;

- ✚ kryen analiza spektrale/inxhinierike për menaxhimin efekti dhe efikas të spektrit frekuencor;
- ✚ analizon zhvillimet e shërbimeve të reja në domenin e shfrytëzimit të spektrit frekuencor duke shqyrtuar mundësítë dhe kushtet teknike të ofrimit të tyre në vend;
- ✚ Tarifon resurset frekuencore të përcaktuar për dhënie në shfrytëzim, analizon dhe përcakton tarifat per radio-frekuencia në funksion të futjes së shërbimeve të reja të avansuar që planifikohen të hyn në tregun e telekomunikimeve në Kosove (si p.sh; shërbimet 3G/UMTS, BWA, TETRA, etj.).

SEKTORËT (ZYRAT)

Sektori i Radio-monitorimit të spektrit radio-frekuencor

Funksion si sektor me specifika të caktuara brenda dhe nën mbikëqyrjen e departamentit të DMF-së dhe mbahet përgjegjëse për përbushjen e detyrateve dhe përgjegjësive të mëposhtme;

- ✚ monitorimin e resurseve frekuencore në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- ✚ monitorimin mbi shfrytëzimin e spektrit frekuencor nga operatoret e licencuar përfshi këtu mbikëqyrjen e përbajtjes së kushteve të licencave;
- ✚ identifikimin dhe rekomandimin mbi mënyren e eliminimit të interferencave si rezultat i shfrytëzimit ilegal/legal nga operatoret shfrytëzues të spektrit frekuencor;
- ✚ monitorimin e kushteve të shfrytëzimit të spektrit frekuencor të përcaktuara në koordinim sipas marrëveshjeve ndërmjet rregullatorëve të shteteve fqinje në zonat kufitare;
- ✚ pranimin dhe shqyrtimin e ankesave nga subjektet e licencuara lidhur me interferimet dhe kushtet e veprimit të tyre.

Sektori i Shërbimit Postar

Sektori në fjalë është themeluar si obligim i dal për ART-në me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 03/L-173 për Shërbimet Postare. Detyrat dhe kompetencat e sektorit për shërbimet postare, janë të përkufizuara me nenin 6 të ligjit për Shërbimet Postare. Funksionimi i sektorit dhe ushtrimi i kompetencave të ART-së në lëmin/fushën e shërbimeve postare efektivisht kanë filluar së jetësuarit për herë të parë gjatë vitit 2011.

Sektori i shërbimit postar, mbahet përgjegjës për përbushjen e detyrateve dhe përgjegjësive të mëposhtme;

- ✚ mbikëqyrjen dhe monitorimin e tregut të shërbimeve postare në territorin e Republikës së Kosovës në përputhje me ligjin për shërbime postare dhe ligjet tjera aplikative;
- ✚ bashkërendimin e punëve dhe aktiviteteve në sektorin postar në mes rregullatorit (ART-së) dhe ministrisë së vijës dhe operatorëve postar;
- ✚ pranon, trajton dhe përgatitë raportet për aplikacionet e pranuara dhe paraqet raportin/et me rekomandime përkatëse lidhur me licencimin e operatorëve postar;
- ✚ paraqet për shqyrtim dhe miratim nga Bordi Drejtues, propozimet për tarifat për shërbimet universale dhe shërbime të rezervuara postare;
- ✚ monitoron përdorimin e tarifave për shërbimet postare dhe në rast shkeljeve propozon masat;
- ✚ pranon, evidenton dhe shqyrton ankesat e operatorëve të licencuar postar dhe shfrytëzuesve / përdoruesve të shërbimeve postare;
- ✚ trajton mosmarrëveshjet në mes të operatorëve postar dhe mosmarrëveshjet në mes të shfrytëzuesve / përdoruesve dhe operatorëve postar;

- administron dhe azhurnon regjistrin me të dhënat përkatëse për operatorët e licencuar postar;
- mbledh informacione të nevojshme që kanë të bëjnë me sektorin postar dhe i publikon ato sipas nevojës; dhe
- kryen dhe punë tjera në përputhje me dispozitat e ligjit 03/L-173 për shërbime postare dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij ligji.

Zyra Ligjore

Si njësi funksionale është e fuzionuar brenda dy departamenteve kryesore profesionale; asaj të DT-së dhe DMF-së, me nga një zyrtar ligjor të cilët në rast nevoje me përkrahjen dhe bashkëponojne me zyrtarin ligjor i cili ushtron pozitën e udhëheqësit të administrates pranë ART-së. Zyrtarët ligjor ofrojnë mbështetje ligjore sipas ligjeve në fuqi në Kosovë, për të gjitha çështjet në sektorin e telekomunikimeve dhe postare, marrin në shqyrtim draftet e legjislacionit dytësor dhe aktet e tjera nënligjore dhe përcjellin komentet e tyre për shqyrtim të Bordit Drejtues, si dhe janë përgjegjës për përgatitjen e të gjitha llojeve të draft licencave, autorizimeve dhe procedurave të aplikueshme në sektorin e telekomunikimeve dhe atij postar.

Shefat e departamenteve dhe udhëheqësit e sektorëve brenda të cilave struktura edhe ushtrojnë detyrat e tyre zyrtarët ligjor janë dhe mbahen përgjegjës për sigurimin e aplikimit të legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në sektorin e telekomunikimeve dhe sekorin postar në Kosovë dhe zyrtarët ligjor në varësi nga çështja-et subjekt i shqyrtimit merren dhe trajtojnë ankesat e konsumatorëve dhe angazhohen në punën e komisioneve funksionale të caktuara për/mbi zgjidhjen e kontesteve ndërmjet operatorëve. Gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, këta zyrtar obligohen të bashkëpunojnë me të gjitha strukturat relevante të ART-së dhe nëse e nevojshme edhe me organizatat të cilat në mënyrë legjitime i përfaqësojnë të drejtat e konsumatorëve.

Departamenti i Administratës

Administrata e ART-së me zyren e financave dhe atë të prokurimit janë përgjegjëse për ofrimin e përkrahjes administrative ndaj Bordit Drejtues, departamenteve dhe sektorëve profesionale të ART-së, për përbushjen sa më efikase të detyrave të tyre si dhe mbahen përgjegjëse për hartimin e planit financiar, implementimin e planit financiar (buxhetit të aprovuar për ART-në) si dhe planit vjetor të prokurimit.

Ngritura e kapaciteteve të ART-së - projektet e asistencës teknike, kurset dhe trajnimet

ART i kushton vëmendje të veçantë ngritjes së vazhdueshme profesionale të personelit të saj, me qëllim të përbushjes efikase të detyrave dhe përgjegjësive ligjore. Për këtë qëllim ART gjatë vitit 2011 si pjesë integrale të planit të punës ka hartuar edhe planin për aktivitetet e synuara në ngritje të kapaciteteve profesionale si dhe ka përgatitur dhe prezantuar projekt-propozime dhe për gjitha ato edhe ka siguruar përkrahjen dhe financim nga donatorë të ndryshëm.

Projektet e Asistencës Teknike

Tre (3) projektet e ART-së të prezantuara për asistencë teknike, janë aprovuar dhe kanë gjetur përkrahjen dhe financimin e Komisionit Evropian, përmes mekanizmit të saj të njojur si TAIEX. Projektet në fjalë janë;

- i. Ndhima teknike përfundimi i procesit të analizës së tregut

(e përfunduar Faza 1: 07-15 Nëntor 2011)

- ii. Draftimi i Rregullores për konformitetin e pajisjeve
(e përfunduar Faza 1: 01-03 Nëntor 2011)
- iii. Harmonizimi i Planit të numeracionit
(e përfunduar Faza 1; 12-16 Dhjetor 2011)

Gjitha projektet e specifikuara si më lartë janë të aprovuara në dy faza të ndara me gjithsej **45** ditë të plota të asistencës direkte të njohur si 'Hands-on Assistance' nga ekspertë të telekomunikacionit me background rregulator të ardhur nga shtetet me ngjashmëri dhe trashëgimi më të afërt nga përvoja e tranzicionit të tregjeve nga tregjet e kontrolluara në tregje të rregulluara dhe të hapura për kapitalin privat dhe konkurrencë efektive.

Ndërsa një (1) projekt (i aprovuar ne vitin 2010 dhe i implementuar në vitin 2011) ka qenë mision studimor 3 ditor në/me Rregulatorin e shtetit të Finlandës me qëllim të njoftimit dhe përfitimit nga praktikat më të mira rregullatore në fushën e zhvillimit dhe adoptimit të legjislacionit dytësor.

Qëllimi themelor i këtyre projekteve ka qenë përkrahja e ART-së në zhvillimin dhe kompletimin e mëtejshmë të legjislacionit dytësor, në zbatimin efikas të procedurave rregullatore dhe në përbushjen e kërkesave që rrjedhin nga ligji i telekomunikacionit dhe nga obligimet e PVPE-së në fushën e komunikimeve elektronike.

Gjatë muajit shkurt 2011, është realizuar edhe trajnimi në kohëzgjatje prej 5 ditëve të trajnimit intensiv me ekspertët gjerman të kompanisë së specializuar LStelcom që njëherë janë edhe zhvillues të softuerit për menaxhimin e spektrit frekuencor. Softveri për menaxhimin e spektrit frekuencor përmban 4 module softuerike të avansuara të domosdoshme për menaxhimin e spektrit frekuencor si; SPECTRAplus, SPECTRAplan, SPECTRAemc dhe MONITORplus. Të gjitha keto module janë në shfrytëzim të përditshëm nga stafi profesional i departamentit të menaxhimit të frekuencave e që ka të bëj me mbajtjen dhe përditësimin e të dhënavë teknike të kanaleve frekuencore në shfrytëzim nga gjithë operatorët dhe shfrytëzuesit e autorizuar të resurseve frekuencore. Përmes këtyre moduleve softuerike arrihen të realizohen analizat spektrale të domosdoshme në planifikimin dhe shfrytëzimin efikas të spektrit frekuencor si dhe në shmangjen e interferencave të kanaleve frekuencore në të dhëna në shfrytëzim.

Në Aneksin C të këtij raporti kemi paraqitur në formë të përbledhur gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2011 në përbushje të objektivit kontinuel për ngritjen e kapaciteteve dhe resurseve profesionale pranë ART-së.

RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit financohet nga të hyrat vetjake, në pajtim me Ligjin për Telekomunikacion, Kapitulli I, neni 5 përkatësish nga taksat (tarifat) rregulative që mblidhen nga operatorët e licencuar që operojnë në sektorin e telekomunikacionit.

Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura të ART-së depozitohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në llogarinë zyrtare të ART-së të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit.

Në vitin 2011, ART ka realizuar të hyra në shumë prej 18,043,502.89 €.

ART edhe gjatë vitit 2011, si rezultat i interpretimeve të ndryshëm të dispozitave të ligjeve të aplikueshme dhe praktikave të vendosura me procedurat e përcaktimit të kufijve buxhetor na MF, nuk ka mundur në mënyrë efektive ta realizoj dhe ushtroj pavarësinë e plotë operacionale duke nënkuptuar këtu në pavarësinë financiare, e cila në interpretim të dispozitave të ligjeve të aplikueshme do duhej të nënkuptonte dhe interpretohej si kompetencë dhe autorizim për planifikim kundrejt nevojave reale, duke nënkuptuar këtu ngritjen e kapaciteteve dhe resurseve adekuate kuadrovike, rikthimin proporcional të hyrave në/përmes projekteve kapitale (investimeve) në sektorin e telekomunikacionit si dhe mundësinë e bartjes së një pjese të të hyrave nga teprica e viti paraprak në rast nevoje për të plotësuar kërkesat buxhetore për projektet në vijim të bartura nga vitet paraprake.

Buxheti

Kuvendi i Kosovës, me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. Nr. 04/L-001 për vitin 2011, ka miratuar buxhetin e Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit në lartësi prej 1,562,474. 00 €, i ndarë në kategoritë kryesore ekonomike si në tabelen e paraqitur si ne vijim;

Tabela 1: Buxheti i ART-së i aprovuar nga Kuvendi

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	266,488.00
Mallra dhe shërbime	405,986.00
Shpenzime komunale	15,000.00
Shpenzime kapitale	875,000.00

Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e aprovuar për vitin fiskal 2011 është 804,487.61 € apo i paraqitur në përqindje në lartësi prej 50.52%.

Shkalla e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, e shprehur në përqindje, është e paraqitur në tabelën e mëposhtme;

Tabela 2: Realizimi i Buxhetit të ART-së

Përshkrimi	Buxheti	Realizimi	Ndryshimi	Realizimi ne (%)
Paga dhe mëditje ²	296,488.00	295,196.06	1,291.94	99.56%
Mallra dhe shërbime	405,986.00	319,133.29	86,852.71	78.61%
Shpenzime komunale	15,000.00	10,332.21	4,667.79	68.68%
Shpenzime kapitale	875,000.00	179,826.05	695,173.95	20.55%

Gjithsesi, marrë në konsideratë faktin se gjatë kvartalit të tretë të vitit 2011, sipas kërkësës së Ministrisë së Financave mbi deklarimet e organizatave buxhetore mbi vijueshmërinë e projekteve kapitale, ART me kohë dhe brenda procedurave të rregullta është deklaruuar mbi lejimin e shkurtimit të buxhetit të ART-së në lartësi prej 625,000.00 € me çka pas këtij shkurtimi, buxheti i ART-së ndryshon, si në strukturë po ashtu edhe në shumën e përgjithshme të tij.

Tabela 3: Buxheti i ART-së pas ndryshimeve

Përshkrimi	Buxheti
Paga dhe mëditje	296,488.00
Mallra dhe shërbime	405,986.00
Shpenzime komunale	15,000.00
Shpenzime kapitale	250,000.00

Nisur nga ndryshimi i mësipërm, realizimi i buxhetit për vitin fiskal 2011 është 804,487.61 € apo i paraqitur në përqindje në lartësi prej 83.20%.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme shihet se në vitin 2011, ART ka arkëtuar të hyra në vlerë prej 18,043,502.89 €, që janë më të larta sesa shpenzimet buxhetore të realizuara në vlerë prej mbi 17.2 milion euro. Ndryshimi mes të hyrave dhe shpenzimeve në vlerën e paraqitur, paraqet fondet suficitare që ART ka mbledhur gjatë vitit dhe të cilat, në pajtim me nenin 5 paragrafi 4 të Ligjit për Telekomunikacion dhe nenin 6 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, janë mbajtur në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

² Buxheti i ART ka pesuar ndryshime ne vlerë prej 30,000 € ne kategorin paga dhe meditje sipas vendimit te QeK Vend. Nr. 03-048

AKTIVITETI RREGULATOR GJATË VITIT 2011

Gjatë vitit 2011, ART ka adoptuar dhe miratuar aktet e mëposhtme rregullatore dhe administrative;

Rregulloret;

1) Rregullorja për 'Sigurimin e Qasjes'

Reg. Nr. 06 (Ref. Nr. Prot. 011/B/11)

Objektivat e rregullores janë;

- ✚ përcakton kushtet për publikimin e Ofertës Referuese për të siguruar qasje dhe të shërbimeve të lidhura, kërkesat mbi përbajtjen e Ofertës Referuese, procedurën dhe kushtet për sigurimin e qasjes dhe shërbimeve përcjellëse të specifikuara në Ofertën Referuese si dhe informatat;
- ✚ sigurimin që ndërmarrjet nuk do të diskriminohen dhe do të kenë mundësi të barabarta sipas kushteve të drejta, objektive dhe transparente për të fituar qasje;
- ✚ rregullorja gjen zbatim ndaj ndërmarrjeve, të cilat sipas procedurës së themeluar nga aktet ligjore konsiderohen ndërmarrje me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës dhe të cilat ekzekutojnë detyrimet e përcaktuar sipas nenit 57 të Ligjit për Telekomunikacionin.

2) Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Licenca dhe Autorizime

Reg. Nr. 07 (Ref. Nr. Prot. 016/B/11) e cila i plotëson Rregulloren Nr. 01/2005 dhe Rregulloren Nr. 182/07-B)

Objektivat e rregullores janë;

- ✚ promovimit të konkurrencës efektive dhe të pa-anshme në mes të operatorëve të rinj dhe atyre ekzistues;
- ✚ inkurajimin dhe krijimin e lehtësive për ofruesit e shërbimeve telekomunikuese dhe palëve tjera të interesuara.

3) Rregullorja për Bashkëshfrytëzimin e Plotë dhe të Përbashkët të Lakut Lokal

Reg. Nr. 08 (Ref. 024/B/11)

Objektivat e rregullores janë;

- ✚ implementimin e dispozitave të Ligjit të Telekomunikacionit, ndërlidhur me promovimin e investimeve dhe konkurrencest së lirë në tregun e telekomunikimeve;
- ✚ adaptimin dhe zbatimin e politikave që synojnë forcimin e liberalizimit të plotë dhe krijimin e një ambienti të hapur dhe konkurrent me qëllim të tërheqjes së investorëve të huaj dhe përmirësimit të kualitetit të shërbimeve;
- ✚ sigurimin që ndërmarrjet/ofruesit e shërbimeve telekomunikuese nuk do të diskriminohen dhe do të kenë mundësi të barabarta sipas kushteve të drejta, objektive dhe transparente për të fituar qasje në rrjetin e operatoreve te përcaktuar me fuqi të ndjeshëm në treg.

4) Rregullorja për Interkoneksion

Reg. Nr. 09 (Ref. Nr. Prot. 033/B/11)

Objektivat e rregullores janë;

- ↳ inkurajojë dhe nëse është e nevojshme të detyroj zbatimin e interkoneksionit dhe bashkëveprimit të shërbimeve, me qëllim të promovimit të konkurrencës efikase dhe të qëndrueshme përfitit maksimal të përdoruesit fundore.

5) Rregullorja për Operimin e Nyjes Shkëmbyese të Internetit

Reg. Nr. 10 (Ref. Nr. Prot. 046/B/11)

Objektivat e rregullores janë;

- ↳ krijimin e kornizës ligjore për operimin e Nyjës Shkëmbyese të Internetit në Kosovë, përfshirë këtu rregullat për anëtarësimin, të drejtat dhe obligimet, si dhe nivelin e shërbimeve minimale;
- ↳ krijimin e kushteve për shkëmbimin e thjesht të trafikut të internetit në mes të ofruesve të shërbimeve të internetit në Kosovë, duke mos ngarkuar rrjetet e treta, si mundësimin e avancimit të sigurisë dhe privatësisë së komunikimeve të internetit duke mbajtur trafikun vendor 'lokal' brenda kufijve kombëtar;
- ↳ ngritjen e kualitetit nga aspekti teknik përmes krijimit të lidhjeve të shpejta në mes të përdoruesve lokal të internetit duke pakësuar efektin vonesë (latency) dhe evitar probleme të caktuara teknike
- ↳ obligimin e gjithë ISP-ve të cilët kanë ose mirëmbajnë lidhjet ndërkombëtare për ofrimin e shërbimeve të internetit, që të anëtarësohen në KOSIX në përpjekje me dispozitat e përcaktuara nga ART.
- ↳ zvogëlimin e kostos mesatare për bit përmes mundësimit të shkëmbimit direkt të trafikut në mes të ISP-ve

6) Rregullorja për të Dhënat Statistikore Periodike të Operatorëve të Shërbimeve Telekomunikuese dhe Postare

Reg. Nr. 11 (Ref. Nr. Prot. 047/B/11)

Objektivat e rregullores janë;

- ↳ përcaktimi i obligimit për dorëzimin e të dhënave periodike për shërbimet dhe rrjetet e telekomunikacionit të ofruara nga operatorët e licencuar dhe operatorët postar, përfshirë edhe detyrimet dhe afateve kohore për dërgimin e të dhënave;

7) Rregullorja mbi Parimet dhe Procedurat e Inspektimit të zhvilluara nga ART

Reg. Nr. 12 (Ref. Nr. Prot. 065/B/11)

Objektivat e rregullores janë;

- ↳ përcaktimin e procedurave dhe parimeve lidhur me aktivitetet e inspektimit të kryera nga ART;
- ↳ përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të njësive relevante dhe të inspektorit si dhe gjithashtu edhe obligimet e palëve qe janë subjekt i inspektimit.;

Vendimet

Në vazhdim paraqesim disa nga aktet më të rëndësishme rregullatore të administruara gjatë vittit 2011.

- ✚ Vendimi për fillimin e Analizës së Tregut të Telefonisë Fikse
Vendimi Nr.58 (Ref. Nr. Prot. 002/B/11)
- ✚ Vendimi mbi 'Caktimin e dënimit per përdorim te disa kanaleve dhe brezeve te pa-licencuara dhe pa-autorizuara'
Vendimi Nr. 60 (Ref. Nr. Prot. 004/B/11)
- ✚ Vendimi për miratimin e 'Tabelës së Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektit Frekuencor'
Vendimi Nr. 62 (Ref. Nr. Prot. 006/B/11)
- ✚ Vendimi per 'Miratimin e tarifave për licencimin e operatorëve postar dhe vendosja e tarifës së rregulltë vjetore (One-Off-fee) për operatorët e shërbimeve postare.
Vendimi Nr. 80 (Ref. Nr. Prot. 21/B/11)
- ✚ Vendimi për tarifim të spektrit frekuencor dhe përdorim pa-autorizuar
Vendimi Nr. 83(Ref.Nr.Prot. 026/B/11)
- ✚ Vendimi për 'Miratimin e Rekomandimit për Qeverinë e Repubikës së Kosovës dhe Metodologjisë së përcaktimit të vlerës për ndarjen e 2x10MHz në Brezin 1800 MHz për operatorin PTK sh.a/Vala'
Vendimi Nr. 117 (Ref. Nr. Prot. 040/B/11)
- ✚ Vendimi për caktimin e dënimit mbi përdorimin e pa-autorizuar të kanaleve frekuencore
Vendimi Nr. 124 (Ref. Nr. Prot. 049/B/11)
- ✚ Vendimi për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të Radio Spektit Frekuencor 2x10 MHz në brezin 1800 MHz për shërbime telekomunikuese mobile në tërë territorin e Republikës së Kosovës për nevojat e Operatorit PTK sh.a/Vala konform termeve të Licencës ART Ref. Nr. 111/04.
Vendimi Nr. 134 (Ref. Nr. Prot. 053/B/11)
- ✚ Vendimi për plotësimin e Licencës ART Ref .Nr. 111/04 për operatorin PTK sh.a/Vala
Vendimi Nr. 135 (Ref. Nr. Prot. 054/B/11)
- ✚ Vendimet per caktimin e denimit për kundërvajtje ndaj personin fizik për mos-përmbushje të detyrimit financiar
Vendimi Nr.136 (Ref. Nr. Prot. 055/B/11), Vendimi Nr. 137 (Ref. Nr. Prot. 056/B/11) dhe Vendimi Nr. 138 (Ref. Nr. Prot. 057/B/11)
- ✚ Vendimi për fillimin e analizës së tregjeve të telefonisë mobile
Vendimi Nr. 153 (Ref. Nr. Prot. 070/B/11)

Licencimet


A. Licencat për Ofruesit e Shërbimeve Telekomunikuese

Tabela e mëposhtme paraqet numrin licencave të lëshuara nga ART ndaj ofruesve të shërbimeve telekomunikuese gjatë vitit 2011 me përshkrimin e shërbimeve telekomunikuese të licencuara.

Tabela 4: Numri i licencave dhe shërbimet e licencuara gjatë vitit 2010 nga ART

	2011
Numri i licencave të dhëna nga ART	38
Licencë për Shërbime të Internetit	25
Licencë për Shërbime me Vlerë të Shtuar	11
Licencë për Shërbime Telekomunikuese Ndërkombëtare	1
Licencë për Nyje dhe Pajisje Telekomunikuese Ndërkombëtar	1
Licencë për Shërbime të Telfeonisë Fikse	
Licencë për Shërbime Telekomunikuese Mobile – GSM	
Licencë për Sherbime MVNO (Mobile Virtual Network Operator)	
T O T A L I	38

Figura 1: Numri i licencave të lëshuara nga ART gjatë viteve 2004 deri 2011



B. Licencat individuale për shfrytëzuesit e resurseve frekuencore

Shërbimet e licencuara për shfrytëzim të spektrit radio-frekuencor gjatë vitit 2011 janë;

- Shërbimet radio të lëvizshme profesionale RLP (PMR – Professional Mobile Radio)
- Shërbimet fikse mikrovalore PTP (Pikë në Pikë)
- Shërbimet aeronautike
- Shërbimet satelitore (VSAT)

Gjatë vitit raportues (2011), ART ka lëshuar gjithsej **244** licenca për shfrytëzuesit e spektrit/kanaleve radio-frekuencore që krasuan me vitin 2010 në aspektin kuantitativ të licencave të lëshuara është për 66% më e madhe ndërsa në aspektin monetar është për 113,546.25 € më e lartë. Kjo performancë është realizuar fal matjeve të kryera gjatë monitorimeve në terren të kryera nga sektori i radio-monitorimit (gjithsej 102) si dhe mbikëqyrjes efikase të rekordeve (shënimive) të administruara në softuerët dhe databazat aplikative të ART-së.

Tabela në vijim paraqet llojin e licencave, numrin e operatorëve në shfrytëzim të brezeve frekuencore dhe numrin e kanaleve frekuencore të licencuara nga ART me rekomandim nga DMF gjatë vitit 2011.

Tabela 5. Lista e licencave sipas brezeve, numri Licencave te operatoreve dhe numri i kanaleve frekuencore ne shfrytëzim

Lloji i licencës	Numri i operatoreve në shfrytëzim të brezeve frekuencore	Numri i kanaleve frekuencore
Licenca për shërbime ne brezin frekuencor HF (9 kHz deri 30 MHz)	2	152
Licenca për shërbimin PMR (brezi 156-174 MHz) VHF	75	149
Licenca për shërbimet PMR (442-470 MHz) UHF	112	188
Licenca për shërbimet PMR (brezi 156-174 & 442-470 MHz) VHF&UHF	15	227
Licenca e shërbimeve fikse Mikrovalore brezi > 3 GHz (SHF)	29	942
Licenca e shërbimeve fikse PMR (brezi 442-470 MHz & Fikse 3-30 GHz) UHF & SHF	1	30
Licenca për shërbime te Aeronautikës	1	2
Licenca për shërbime Satelitore	9	9
Gjithsej	244	1,699

Në ueb faqën e ART-së, linkun <http://www.art-ks.org/?cid=1,52,465> mund të shkarkohen dhe shiqohen lista e të gjitha licencave të radio-frekuencave të leshuara/autorizuara për përdorim nga ART për shfrytëzuesit e spektrit frekuencor gjatë vitit kalendarik 2011.

C. Autorizimet (vendimet) për shfrytëzimin e resurseve numerike

Gjatë vitit 2011, sipas rekomandimeve të Departamentit të Telekomunikacionit janë nxjerr gjithsej 41 vendime administrative për alokimin (ndarjen) e 67 numrave jo-gjeografik ndaj 41 ofruesve të shërbimeve telekomunikuese.

Në ueb faqën e ART-së, linkun <http://www.art-ks.org/?cid=1,50,455> mund të shkarkohet i gjithë regjistri i numeracionit të alokuar (ndarë) nga ART-ja deri në datën e azhornimit (përditësimit) të saj.

PASQYRË E PËRGJITHSHME E TREGUT TË TELEKOMUNIKEVE

Tregu i telekomunikimeve në Kosovë edhe përgjatë vitit 2011 ka vazhduar të njoh dhe registroj trende pozitive dhe karakterizohet me zhvillim të shpejtë dhe kompetitiv të ofertës së shërbimeve përkundër uljes së çmimeve të disa nga shërbimet bazë gjitha këto të mundësuara pas liberalizimit të tregjeve si të paraparaë me Ligjin e Telekomunikacionit dhe Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit.

Numri i operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve që janë licencuar nga ART për ofrimin e shërbimeve të telekomunikimeve deri në fund të vitit 2011 ishte 86 ne krahasim me 48 në fund të vitit 2010. Referuar 'Regjistrat të Operatorëve të Licencuar' gjendja në fund të vitit 2011 paraqitet si në tabelën në vijim;

Tabela 6. Numri i licencave te dhena nag ART dhe te ndara sipas kategorive te licencave

Gjithsej numri i licencave të dhëna nga ART	86
Licencë për Shërbime të Internetit	38
Licencë për Shërbime me Vlerë të Shtuar	29
Licencë për Shërbime Telekomunikuese Ndërkombëtare	6
Licencë për Nyje dhe Pajisje Telekomunikuese Ndërkombëtar	6
Licencë për Shërbime të Telefonisë Fikse	3
Licencë për Shërbime Telekomunikuese Mobile - GSM	2
Licencë për Sherbime MVNO (Mobile Virtual Network Operator)	2
T O T A L I	86

Edhe gjatë vitit 2011, tregu i telekomunikimeve vazhdoi të rritet me ritme të larta e sidomos segmenti i tregut të telefonisë mobile. Megjithatë, zvoglimi i numrit të përdoruesëve të telefonisë fikse nuk ka ndikuar drejtpërdrrjtë edhe në rënjen e të ardhurave që nënkupton rritje të përdorimit dhe komunikimit nga ana e përdoruesëve. Trende negative në krahasim me vëllimin e të hyrave për herë të parë është shënuar në tregun e shërbimeve të internetit dhe shërbimeve të linjave me qira kryesisht bazuar në rritjen e konkurrencës së shërbimeve mes operatorëve dhe uljen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve, por edhe ndërprerjen e ofrimit të shërbimeve nga ana e një operatori të licencuar.

Gjithashtu, nëse vlerësuar performancën e operatorëve kryesor menduar këtu në të hyrat e poërgjithshme në nivel të operatorëve por edhe në nivel të tregjeve kryesore vërejmë trende pozitive me rritje një shifrore tek operatorët që kanë realizuar të hyra në vlera 8 shifrore dhe rritje dy shifrore tek operatorët që kanë realizuar të hyra në vlera 7 shifrore.

Dy operatorët e rrjeteve mobile, zotërojnë rreth 97% të të ardhurave të gjithe sektorit të telefonisë mobile ndërsa dy operatorët virtual zotërojnë rreth 3% të të ardhurave të sektorit të telefonisë mobile. Të ardhurat e operatorëve mobil (përshi këtu operatorët e rrjetës dhe ata virtual) përfaqësojnë mbi 83% të të ardhurave të gjithë tregut të telekomunikimeve.

Per sa u perket investimeve të kryera gjatë vitit 2011, sipas shënimave të deklaruara nga operatorët rezulton të jetë rreth 38 mnl € apo mbi 24% më e lartë se ajo krahasuar me vitin 2010.

Numri i të punësuarve me kontrata të rregullta pune (kohë të plotë) nga operatorët e licencuar në vitin 2011 ishte mbi 3,850 ku operatori me numrin më të madh të të punësuarve vazhdon të jetë operatori publik, PTK Sh.a me rreth 80% të të gjithë të punësuarve në sektor.

Në figurën 2 është paraqitur ecuria e liberalizimit të plotë të shërbimeve telekomunikuese në shtetet e ardhshme të zgjerimit të Bashkimit Evropian (BE). Siç shihet nga figura, liberalizimi i plotë i shërbimeve telekomunikuese ka përfunduar pothuajse në të gjitha shtetet rajonale.




Figura 2: Liberalizimi i plotë i shërbimeve telekomunikuese (Burimi: Cullen International)

Në tabelën në vijim janë paraqitur në mënyrë të përbledhur disa nga indikatorët kryesor të shërbimeve telekomunikuese për vitin 2011 si dhe krahasimet e këtyre indikatorëve me periudhat e mëhershme, gjegjësisht vitin 2010.

Tabela 7: Indikatorët kryesor të Tregut të Shërbimeve Telekomunikuese

Nr.	Pershkrimi	2011		Ndryshimi me vitin 2010 (%)	2009	Ndryshimi me vitin 2009 (%)
		2011	2010			
1.	Numri i linjave të telefonisë fiksë	315,952	315,952	0.00%	303,797	4.00%
1.1.	Numri i përdoruesve të telefonisë fiksë në fund të viteve	86,014	88,372	-2.67%	82,084	4.79%
1.2.	Numri mesatar i përdoruesve të telefonisë fiksë sipas TM-ve per vitet	87,121	88,377	-1.42%	83,500	4.34%
1.2.	Penetrimi i telefonisë fiksë (%)	5.02%	5.09%	-1.38%	4.81% ³	4.37%
2.	Numri i përdoruesve të telefonisë mobile në fund të viteve	1,478,944	1,451,747	-2.67%	1,359,170	8.10%

Nr.	Përshtrimi	2011	2010	Ndryshimi me vitin 2010 (%)	2009	Ndryshimi me vitin 2009 (%)
2.1	Numri mesatar i përdoruesve të telefonisë mobile sipas TM-ve përvitet	1,473,166	1,438,475	2.41%	1,208,840	21.87%
2.2.	Penetrimi i telefonisë mobile (%)	84.96%	82.96%	2.41%	69.72% ⁴	21.86%
3.	Numri i përdoruesve të internetit në fund të viteve	143,243	126,415	13.31%	136,711	4.78%
3.1.	Numri i përdoruesve të internetit	137,240	109,720	25.08%	136,711	0.39%
3.2.	Penetrimi i shërbimeve të internet-it (%)	7.92%	6.33%	25.12%	7.88%	0.51%
4.	Te hyrat (€) ⁵	239,518,037.36	222,491,069.80	7.65%	209,464,183.40	14.35%
4.1.	Telefonia fiks	20,039,454.93	20,026,000.00	0.67%	20,972,000.00	-4.45%
4.2.	Telefonia mobile	199,243,326.00	181,236,432.00	9.94%	170,637,460.00	16.15%
4.3.	Linjat me qira	1,628,849.54	1,657,151.00	1.70%	872,512.38	86.68%
4.4.	Qasja në internet	18,606,406.89	19,571,486.80	-4.93%	16,982,211.00	9.56%
5.	Investimet	38,240,000	30,777,237.11	24.33%	33,941,294.16	12.74%

Në fund të vitit 2011 numri i përdoruesve të telefonisë fiks ka rënë në 86,014. Pra, numri i përdoruesve të telefonisë fiks përvitet 2011 ka shënuar një rënje prej 2,358 përdoruesish ose rënje prej 2.67%. Numri mesatar i përdoruesve aktiv⁶ të telefonisë fiks përvitet 2011 vlerësohet të jetë rreth 87,121. Pjesa prej 82,151 i takon operatorit PTK sh.a./Telekomit të Kosovës (TiK), ndërsa pjesa tjeter prej 4,971 përvitet alternativ IPKO.

Ndërsa, në fund të vitit 2011, numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka arritur në shifrën prej 1,478,944, që paraqet një rritje prej 27,197 përdoruesish ose shprehur në përqindje paraqet një rritje prej 1.87%, përkatesisht ka shënuar rritje përvjetore 8.81% në krahësim me vitin 2009. Gjatë vitit 2011, mesatarja e numrit të përgjithshëm të përdoruesve të telefonisë mobile ishte rreth 1,473,166 përdorues, që paraqet një rritje prej 34,691 përdoruesish ose 2.41% në krahësim me vitin paraprak (2010), përkatesisht eshtë rritur përvjetore 21.87% në krahësim me vitin 2009.

Derisa telefonia fiks ka shënuar një rënje të lehtë, rënje kjo edhe e pritur, telefonia mobile dhe shërbimet e internetit kanë shënuar rritje të ndjeshme në numrin e përdoruesve krahësim me vitin paraprak (2010). Në fund të vitit 2011, numri i përdoruesve që kanë qasje në shërbimet e internetit ka arritur në 143,243 përdorues, shifër kjo që shënon rritje të konsiderueshme të përdoruesve prej 16,828 ose shprehur në përqindje shënon rritje prej 13.31% në krahësim me vitin e kaluar. Kurse, mesatarja gjatë TM-ve të vitit 2011 ka shënuar rritje përvjetore 27,520 të rinj. Numri i mesatarja e linjave aktive përvitet 2011 eshtë 137,240, e cila paraqet një rritje prej 25.08% në krahësim me vitin 2010 ku mesatarja e linjave aktive ishte rreth 109,720.

⁵ Në totalin e të hyrave janë dhënë të hyrat nga shërbimet përvjetore: Telefonin fiks, Telefonin mobile, dhe Linja me Qira dhe ato të Qasjes në Internet, të cilat janë marrë nga raportet financiare të audiuara të operatorëve dhe ofruesëve të shërbimeve telekomunikuese me përashtim të operatorit PTK Sh.A, e cila ka dorëzuar pasqyrat financiare të certifikuar në nivel korporatë dhe të pa-audituarë dhe krahësimi të tyre me të të ardhurat e PTK Sh.A të nxjerra nga raportet tremujore të certifikuarë dhe të dorëzuara në ART në përmbytje të obligimeve ligjore përvjetore raportim të rregullt tre-mujor

⁶ Vendimi i ART-së Nr. 22 i datës 15 qershor 2010 (ART Nr. Prot. 45/1/10) i definon përdoruesit aktiv të numrave mobil fiks dhe jo-geografik. **Përdorues aktiv mobil:** Prepaid, eshtë çdo përdorues i cili e ka përvdur njërin nga shërbimet telekomunikuese me pagesë apo ka mbushur llogarinë e tyre brenda periudhës tremujore (3). Postpaid, eshtë çdo përdorues i cili ka kontratë valide me ofruesin e shërbimeve të telefonisë mobile. **Përdorues aktiv fiks:** eshtë çdo përdorues i cili ka kontratë valide me ofruesin e shërbimeve të telefonisë fiks.

Pasqyra e të ardhurave nga shërbimet telekomunikuese

Të hyrat nga shërbimet telekomunikuese për vitin 2011 kapin shumën prej 239,518,037.36€, që në krahasim me vitin 2010 del që kemi rritje prej 7.65% të të hyrave. Operatorët e telefonisë mobile dhe fikse vazhdojnë të zotërojnë pjesën më të madhe të tregut të telekomunikacionit me mbi 90% të të ardhurave. Të hyrat e operatorëve mobil përbëjnë rrëth 83.19% të të ardhurave të gjithë tregut, ndërsa operatorët fiks zotërojnë rrëth 8.37 %.




Figura 3 – Shpërndarja e të hyrave sipas veprimtarisë

Në figurën 3 është paraqitur ndarja e të hyrave sipas veprimtarisë për vitet 2011, 2010 dhe 2009. Siç edhe shihet nga figura e mësipërme, trendi i dominimit te të ardhurave nga tregu i telefonisë mobile dominon edhe në vitin 2011. Një trend i tillë ekziston edhe në shtetet rajonale dhe evropiane.

Sa për ilustrim, në figurën 4 janë paraqitur të ardhurat nga sektori i komunikimeve elektronike për vitin 2010, të shteteve të zgjerimit të ardhshëm të Bashkimit Evropian (BE), të cilat monitorohen nga kompania Cullen International⁷. Siç shihet edhe nga figura pjesa më e madhe e tregut dominohet nga telefonia mobile me rrëth 59%, e pasuar nga ajo fiksë, internetit, komunikimet e të dhënave dhe televizionit kabllor. Të hyrat totale nga tregu i komunikimeve

⁷ Cullen International është kompani e kontraktuar nga Komisioni Evropian për monitorimin e tregut te telekomunikacionit, ose siç njihet ndryshe me emrin komunikimet elektronike, ne shtetet te cilat synojnë anëtarësimin ne BE. Këto shtete janë: Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Turqia, Islanda si dhe Kroacia. Informata me te detajuara mund te gjenden ne ueb faqen: <http://www.cullen-international.com/>

elektronike për këto shtete gjatë vitit 2010 ka arritur shifrën në 15.8 miliard euro, me një rritje prej 2.4% ne krahasim me vitin 2009⁸.





Figura 4: Tregu i komunikimeve elektronike ne shtetet rajonale për vitin 2010 (Burimi: Cullen International, Raporti I: Nëntor 2011)

Investimet e bëra në rrjete dhe shërbime telekomunikuese

Investimet e bëra nga operatorët e shërbimeve telekomunikuese për vitin 2011 kapin shifrën prej 38,266,377.33 € e që është një rritje e konsiderueshme krahasuar me vitin e kaluar (2010), ku investimet kanë kapur shifrën prej 30,777,237.11 €.

Në figurën 5 janë paraqitur investimet e bëra për kategori të ndryshme shërbimesh. Siç shihet edhe nga figura në vitin 2011, pjesën më të madhe të investimeve e përbën telefonia mobile 67.40%.



c) Krahasimi i investimeve sipas shërbimeve 2010-2011

Figura 5: Investimet në rrjetet dhe shërbimet telekomunikuese - Krahasimi i investimeve sipas shërbimeve 2010-2011

⁸ Në të hyrat për vitin 2009 nuk ka qene e përfshire edhe Islanda.

TELEFONIA FIKSE

Tregu i Telefonisë fikse në Republikën e Kosovës po zhvillohet me ritme tejet të ngadalësuara. Porse dukuria e njejtë po ngjan edhe në shtetet rajonale dhe ato evropiane gjatë viteve të fundit, ku është vërejtur një ngadalësim, e sidomos në rritjen e penetrimit dhe të hyrave të përgjithshme.

ART-ja deri më tanë ka licencuar tre operatorë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese fikse në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Operatorët në fjalë janë:

- PTK - Telefonia Fikse (Telekomi i Kosovës TiK), e licencuar me datën; 30/07/2004,
- IPKO Telecommunications LLC, e licencuar me datën; 08/09/2006, dhe
- KONET, e licencuar me datën; 02/02/2009.

Prania e tre operatorëve në tregun e telefonisë fikse (dy aktiv duke ofruar shërbime, ndërsa KONET ofron linja me qera), na jep të kuptojmë se kemi të bëjmë me një liberalizim të shërbimeve të telefonisë fikse.

Krahasuar me ritmet e zhvillimi e tregut të telefonisë mobile në Republikën e Kosovës, telefonia fikse edhe përkundër investimeve të bëra në këtë sektor, niveli i mbulimit të territorit dhe popullsisë është shumë i vogël, e si faktor kryesor për shtrirjen e ulët të shërbimeve të telefonisë fikse në tërë territorin e Republikës së Kosovës mund të janë: kompleksiteti i punëve, nevoja për investime të mëdha, kërkesa e ulët për shërbime të tilla, etj.

Numri përdoruesve të telefonisë fikse

Bazuar në të dhënat e operatorëve për vitin 2011, rezulton se janë rreth 87,121 përdorues të telefonisë fikse, që shënon një rënie të vogël në numrin e përdoruesve me afersisht 1,256 përdorues apo rënie prej rreth 1.42% krahasuar me 2010, përkatësisht një rritje prej 4.34% në krahasim me vitin 2009.

Nëse krahasojmë ecurinë e zhvillimit të këtij tregu gjatë periudhës TM1-2009 e deri më TM4-2011, rezulton që telefonia fikse nuk ka një zhvillim të qëndrueshëm, gjë e cila vërehet me lëvizjen e numrit të përdoruesve - rëties së vazhdueshme të tyre.

Në tabelën 7 është paraqitur ecuria e numrit të përdoruesve të telefonisë fikse.

Tabela 8: Numri e përdorueseve të telefonisë fikse (TM3-2008 deri TM4-2011)

VITI	2009				2010				2011				
	Tremujori	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Individual	76,870	77,490	77,608	75,393	76,766	75,557	74,628	74,133	74,539	71,999	69,850	68,629	
Bizneset	6,679	6,624	6,644	6,691	6,855	17,244	14,088	14,239	14,150	15,982	15,955	15,576	
Totali	83,549	84,114	84,252	82,084	83,621	92,801	88,716	88,372	88,689	87,981	85,805	84,205	

Norma mesatare e penetrimit të telefonisë fikse gjatë vitit 2011 ka qenë rreth 5.02%, nivel ky që vazhdon të jetë mjaftë më i ulët se vendet e rajonit me rreth 25% si dhe të normën e penetrimit në shtetet e BE-së me rreth 40% (Figura 6).




Figura 6: Penetrimi i telefonisë fikse gjatë periudhës 2007 – TM4-2011

Në tabelën 8 janë dhënë përqindjet e shfrytëzuesve të telefonisë fikse sipas llojit të përdoruesve. Bazuar në të dhënat e paraqitura vërehet se përqindja e përdoruesve individual është më e lartë në krahasim me përqindjen e bizneseve, e cila gjatë këtij tremujori nuk ka pësuar ndryshime.

Tabela 9: Përdoruesit e telefonisë fikse sipas kategorisë (TM1-2009 deri TM4-2011)

Viti	2009				2010				2011			
	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Individual [%]	91.46	91.58	91.54	91.46	91.53	80.56	83.52	83.3	83.3	81.1	80.8	81.1
Bizneset [%]	8.54	8.42	8.46	8.54	8.47	19.44	16.48	16.7	16.7	18.9	19.2	18.9

Ndarja e tregut

Ndarja e tregut mund të matet nëpërmes treguesve të ndryshëm; sipas numrit të linjave, përdoruesve, minutave të trafikut, dhe të ardhurave. Në figurën 8 është paraqitur ndarja e tregut ndërmjet dy operatorëve të rrjetit dhe ofruesve të shërbimeve telekomunikuese fikse, në bazë të përdoruesve dhe të hyrave.

Edhe gjatë këtij viti, PTK/TiK ka rreth 94.4% të tregut për nga numri i përdoruesve, përkatësisht 95.1% në bazë të të hyrave të realizuara përmes ofrimit të këtyre shërbimeve. Operatori alternativ i shërbimeve të telefonisë fikse, IPKO mbulon një pjesë të vogël të tregut, me vetëm rreth 5.6%, përkatësisht 4.9% në bazë të të hyrave të realizuara përmes ofrimit të këtyre shërbimeve.

Dominimi i operatoreve publik (te njojur/referuar ne gjuhen angleze si 'incumbent') vërehet edhe në shtetet e tjera rajonale dhe evropiane, dhe arrin në kuotën mbi 80%.




Figura 7 – Ndarja e tregut sipas përdoruesve dhe të të hyrave: TM1 2008 deri TM4 2011

Trafiku i telefonisë fikse

Në figurën 8 është paraqitur ecuria e trafikut të telefonisë fikse nga të dy operatorët aktiv në treg, PTK sh.a. dhe IPKO. Nga të dhënat e paraqitura mund të vërehet se trafiku i telefonisë fikse gjatë vitit 2011 ka shënuar rënie të vazhdueshme të lehtë.

Kjo dukuri mund të jetë rezultat i zëvendësimit dhe trendit gjithnjë në rritje të përdorimit të telefonisë mobile në raport me telefoninë fikse. Poashtu, ofertat me tarifa shumë të levërdishme nga operatorët dhe ofruesit e shërbimeve të telefonisë mobile, kanë ndikuar që konsumatorët të zëvendësojnë shërbimet e telefonisë fikse me ato të telefonisë mobile.

Nëse kahasohen të dhënat e trafikut në TM4-2011 në raport me TM4-2010 mund të vërehet se trafiku i telefonisë fikse ka shënuar rënie të ndjeshme prej 17.32.




Figura 8: Totali i Trafikut të origjinuar dhe terminuar të telefonisë fikse

Struktura e thirrjeve në telefoninë fikse

Në figurën 9 është pasqyruar trafiku i detajuar telefonik sipas destinacionit të thirrjeve, i gjeneruar nga dy operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve fikse, dhe atë;

- trafiku brenda rrjetit;
- trafiku drejt rrjeteve të tjera fikse;
- trafiku drejtë rrjeteve mobile; dhe
- trafiku ndërkombëtarë.

Në vitin 2011 nga rrjetet fiks janë origjinuar 158.86 milion minuta të cilat paraqesin një rënie prej 12.90% në krahasim me vitin 2010.

Pjesën më të madhe të trafikut të përgjithshëm në rrjetin e telefonisë fiks e përbën trafiku i origjinuar dhe terminuar brenda rrjetit me rreth 70% e trafikut, 1% trafik drejt rrjeteve tjera fiks kurse pjesën tjeter të trafikut e përbën trafiku drejt rrjetit mobil me rreth 21.40% si dhe pjesën e mbetur ai ndërkombëtarë me rreth 7.6%.

Nëse krahasojmë trafikun e origjinuar gjatë viti 2011, vërejmë një rritje graduale të lehtë në trafikun drejt rrjeteve mobile, ndërsa origjinimi i thirrjeve drejt rrjetit ndërkombëtarë dhe drejt rrjeteve tjera fiks (off net) dhe brenda rrjetit (on-net) kanë shënuar një rënie të lehtë.




Figura 9: Trafiku i origjinuar fiks sipas destinacioneve

Në figurën 10 është pasqyruar trafiku i detajuar telefonik hyrës në rrjetet e dy operatorëve fiks sipas origjinës së thirrjeve;

- nga rrjete të tjera fiks,
- rrjetet mobile, dhe
- trafiku hyrës ndërkombëtar.

Në vitin 2011 në rrjetet fiks janë terminuar 81.1 milion minuta, në këto të dhëna nuk janë përfshirë trafiku i origjinar dhe terminuar brenda rrjetit.

Nga të dhënat e paraqitura në grafik vërehet se trafiku hyrës ndërkombëtar zotëron pjesën më të madhe të thirrjeve të terminuara me mesatarisht 88%, që në këtë vit vërehet një rënie jo e

ndjeshme e këtyre thirrjeve. Ndërsa në thirrjet e rrjeteve mobile ka vazhduar trend i ngashëm me atë të vitit të kaluar.




Figura 10: Trafiku hyrës i telefonisë fiksë

Teknologja e përdorur nga operatorët e licensuar

PTK ka implementuar teknologjinë e rrjetit NGN (Next Generation Network), e cila mundëson integrimin e shërbimeve të zërit, internetit dhe TV.

IPKO është operator alternativ për ofrimin e shërbimeve fiksë përmes teknologjisë VOIP, e cila ofrimin e shërbimeve fiksë e bënë nëpërmes të rrjetit kabllor të shtrirë me investime të veta dhe për nevoja të shërbimeve brez-gjëra. Shërbimet e telefonisë fiksë të operatorit IPKO funksionojnë kryesisht në vende (qytete të mëdha) me të mëdha, e në të cilat ofron edhe shërbimet e internet-it dhe TV kabllor.

KONET është operatori i tretë i licencuar për ofrimin e shërbimeve të telefonisë, i cili nuk ofron shërbime të telefonisë fiksë, por vetëm shërbime të linjave me qira.

Tarifat lokale dhe nationale

Në figurën në vazhdim janë paraqitur tarifat e operatorëve të telefonisë fiksë për 'peak' dhe 'off-peak' brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit. Siç edhe shihet nga figura ekziston një tarifë e vetme për thirrjet lokale dhe nationale, për dallim nga vendet tjera ku këto tarifa ndryshojnë.




Figura 11: Tarifat lokale dhe nationale të telefonisë fikse

TELEFONIA MOBILE

Momentalisht në Kosovë operojnë dy operator të licencuar të telefonisë mobile (Standardi GSM 900/1800);

- PTK Sh.a/Vala e licencuar më datë; 30/07/2004 (ART Nr. Prot. 111/04) me periudhë vlefshmërie prej 15 vite, dhe
- IPKO Telecommunications LLC e licencuar më datë; 06/03/2007 (ART Nr. Prot. 77/07) me periudhë vlefshmërie prej 15 vite

krahas dy operatorëve të licencuar të rrjetave MNO (Mobile Network Operator) të përmendur me lartë, janë licencuar edhe dy operatorë tjerë mobil virtual (MVNO)⁹:

- Dukagjini Telecommunications sh.a. (D3mobile) e licencuar më datë; 24/06/2008 (ART Nr. Prot. 124/08) me një periudhë vlefshmërie prej 15 vite;
- Dardafon.net LLC (Z Mobile) e licencuar më datë; 12/06/2008 (ART Nr. Prot. 112/08) me një periudhë vlefshmërie prej 15 vite.

Përdoruesit e telefonisë mobile

Përdorimi i telefonisë mobile gjatë vitit 2011 nuk ka lëvizur pothuajse fare në krahasim me vitin 2010, nëse marrim si bazë numrin mesatar të përdoruesve gjatë vitit 2010 dhe e krahasojmë me numrin mesatar të përdoruesve për vitin 2011, rezulton që numri i përgjithshëm sillet rrëth 1.5 milion abonentë, pra i ngashëm me atë të vitit të kaluar.

Në figurën 12 është paraqitur numri i përgjithshëm i përdoruesve gjatë periudhës TM4-2007 deri TM4-2011.

⁹ Operatori VALA ka marrëveshje komerciale me Z Mobile, ndërsa IPKO LLC me d3 Mobile.




Figura 12: Numri përdoruesve mobil 2007 deri në TM4-2011

Shkalla e penetrimit të telefonisë mobile gjatë vitit 2011 ka pasur luhatje por me tendencë të rritjes dhe kryesisht është sjell në kuotën rreth 85%; në fund të muajit dhjetor të vitit 2011 penetrimi i telefonisë mobile ka arritur në 85.30% (shih figurën 13)¹⁰.




Figura 13: Penetrimi i telefonisë mobile

Edhe përkundër tendencës në rritje të numrit të përdoruesve të telefonisë mobile, penetrimi i këtij shërbimi është më i ultë në krahasim me vendet e rajonit dhe vendet e BE (figura 14).

¹⁰ Duke marrë parasysh faktin se që nga periudha TM1-2011 llogarija e penetrimit është bërë duke u bazuar në rezultatet preliminare të Entit të Statistikave të Kosovës (numri i popullsisë 1.7 milion), ndërsa për tremujoret paraprak është supozuar se numri i popullsisë është rreth 2.07 milion, atëherë krahasimi në këtë rast nuk gjen zbatim.




Figura 14: Penetrimi i telefonisë mobile janar-2005-janar 2010
(Burimi: Cullen Internacional, Raport IV, Dhjetor 2010).

Ndarja e tregut sipas përdoruesve

Në grafikun e paraqitur më poshtë janë dhënë detalet e ndarjes së tregut të katër operatorëve mobil për periudhën 2007- 2011.




Figura 15: Ndarja e tregut te telefonisë mobile 2007-2011

Të ardhurat e telefonisë mobile

Të ardhurat totale nga ofrimi i shërbimeve të telefonisë mobile nga të katër operatorët mobil gjatë vitit 2011 janë **199.2 milionë EUR**, që shënon një rritje prej rrëth 9.94% në krahasim me vitin paraprak, kur të ardhurat ishin rrëth **181.2 milion EUR**, përkatësisht ka një rritje prej 16.15% në krahasim me vitin 2009 (figura 16).

Në grafikun e mëposhtme është paraqitur tendenca e të ardhurave të telefonisë mobile në periudhën 2007-2010, ku mund të vërehet trend i konsolidimit të të hyrave gjatë vitit 2011 krahasuar me trendët e dy viteve paraprijëse nëse krahasuar për kuartale, të të ardhurave të këtij segmenti të tregut.




Figura 16: Të hyrat nga telefonia mobile




Figura 17: Ndarja e tregut të telefonisë mobile në bazë të të hyrave

Struktura e përdoruesve të telefonisë mobile

Struktura e përdoruesve të telefonisë mobile në raport ndërmjet përdoruesve me parapagim dhe atyre me kontratë edhe në vitin 2011 vazhdon të jetë e qëndrueshme.

Numri i përdoruesve me kontratë (post-paid) në raport me numrin total të përdoruesve është/mbetet shumë i ulët me rreth 4.17% të numrit të përgjithshëm, ndërsa 95.83% e përbëjnë përdoruesit me parapagim.




Figura 18: Struktura e përdoruesve mobil prej TM4-2007 deri TM4-2011

Në figurën 19 është paraqitur struktura e përdoruesve mobil në shtetet rajonale duke përfshirë edhe Kosovën.




Figura 19: Struktura e përdoruesve mobil
(Burimi: Culen internasional, Raporti I, Nëntor 2011)

Trafiku telefonik

Në figurën 20 është pasqyruar trafiku i detajuar telefonik hyrës, i gjeneruar nga dy operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve telefonike mobile, sipas destinacionit të thirrjeve:

- brenda rrjetit,
- drejt rrjeteve të tjera mobile,
- rrjeteve fiksë dhe
- ndërkontëtarë.

Në vitin 2011 nga rrjetet mobile janë origjinuar 1.541 miliard minuta, e cila përbën një rritje prej 4.40% në krahasim me vitin 2010.

Vërehet se trafiku brenda rrjetit ka vazhduar me të njëjtin ritëm edhe vitin 2011, ku thirrjet brenda rrjetit përbëjnë 91.75% të thirrjeve të origjinaluara nga përdoruesit e telefonisë mobile. Kjo vlerë e trafikut brenda rrjetit rezulton të ketë ardhur si rezultat i ofertave dhe programeve të shumta tarifore që ofrojnë thirrje brenda grupeve me tarifa shumë të ulëta, kurse thirrjet drejt numrave gjeografik dhe thirrjet ndërkontinentale përbëjnë një pjesë shumë të vogël të thirrjeve dalëse.

Në figurat e mëposhtme (20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28) është pasqyruar shpërndarja e trafikut dalës në rrjetet e katër operatorëve mobil sipas origjinës së thirrjeve, dhe atë si në vijim;

- të origjinaluara dhe të terminuara në rrjetin e vet,
- drejt rrjeteve të tjera të telefonisë mobile,
- drejt rrjeteve fiks, dhe
- ndërkontinentale.




Figura 20: Shpërndarja e thirrjeve telefonike mobile të origjinaluara të cilat janë terminuara brenda rrjetit (mobil on net) TM4 2007 deri më TM4-2011




Figura 21: Shpërndarja e thirrjeve telefonike të origjinaluara në rrjetet mobil të cilat janë terminuar në rrjetin tjetër mobil (mobil off -net) TM4 2007 deri më TM4-2011




Figura 22: Shpërndarja e thirrjeve telefonike mobile të origjinalit të cilat janë terminuar në rrjetin fiks (Mobile to fixed calls) TM4 2007 deri më TM4-2011




Figura 23: Shpërndarja e thirrjeve telefonike të origjinalit të cilat janë terminuar në rrjetin ndërkombëtar (mobile international calls) TM4 2007 deri më TM4-2011




Figura 24 – Shpërndarja e trafikut të origjinuar nga Operartorët Virtual (MVNO) sipas destinacionit – Numeracioni MVNO




Figura 25 - Shpërndarja e trafikut të origjinuar nga Operartorët Virtual (MVNO) sipas destinacionit – Numeracioni MVNO- drejt rrjetit të operatorit amë




Figura 26 - Shpërndarja e trafikut të origjinuar nga Operatorët Virtual (MVNO) sipas destinacionit – Numeracioni MVNO- drejt rrjeteve tjera mobile




Figura 27 - Shpërndarja e trafikut të origjinuar nga Operatorët Virtual (MVNO) sipas destinacionit – Numeracioni MVNO- drejt rrjeteve Fikse




Figura 28 - Shpërndarja e trafikut të origjinuar nga Operatoret Virtual (MVNO) sipas destinacionit – Numeracioni MVNO- drejtë rrjeteve Ndërkombëtare

Në tremujorin e katërtë të vitit 2011 në rrjetet mobile janë terminuar 112.53 milion minuta.

Nga trafiku i terminuar i thirrjeve nga rrjetet tjera, trafiku hyrës ndërkombëtar zotëron pjesën më të madhe të thirrjeve të terminuara në mbi 71.29%, pjesën tjeter e përbën trafiku i terminuar nga rrjetet mobile prej 21.25% dhe trafiku prej rrjeteve fikse me 7.46%.

Në figurat 29, 30 dhe 31 janë dhënë shpërndarja e thirrjeve të terminuara të operatorëve sipas prejardhjes të ndarë sipas operatorëve të rrjetit.




Figura 29 - Trafiku hyrës mobil nga TM4 2007 deri më TM4-2011




Figura 30 - Trafiku hyrës nga rrjeti fiks prej TM4 2007 deri më TM4-2011




Figura 31 - Trafiku hyrës nga rrjetet ndërkombëtare prej TM4 2007 deri më TM4-2011

Tarifat

Operatorët e telefonisë mobile (MNO dhe MVNO) kanë programe të ndryshme tarifore për grupe të caktuara përdoruesish, prandaj krahasimi i tyre është shumë i komplikuar. Për krahasim duhet të marrim parasysh një numër mjaft të madh parametresh, duke përfshirë tarifat për thirrjet peak dhe off-peak, thirrjet dhe SMS falas që ofrohen në paketa të ndryshme, tarifat në varësi të volumit të trafikut, tarifat e SMS, tarifat për thirrje brenda rrjetit (on-net), tarifat për thirrje në rrjetet tjera mobile (off-net), tarifat për thirrjet në rrjetet fikse, tarifat e aktivizimit, etj.

Për qëllime krahasimore të këtyre tarifave në praktikë përdoren shportat e përdorimit sipas modelit të OECD të cilat në vete përfshijnë;

- 1) ‘përdorues të ulët’ - një përkufizim që përfshin 30 thirrjet në muaj plus 33 mesazhe SMS, 1 MMS dhe mesazh zanor
- 2) ‘përdorues i mesëm’ - 65 thirrje në dalje, 50 SMS, MMS dhe mesazh zanor
- 3) ‘përdorues të lartë’ - 140 thirrje dhe 55 SMS, MMS dhe mezash zanor

Në figurën 32 janë paraqitur shportat e përdorimit të telefonisë mobile të katër operatorëve mobil në Kosovë sipas modelit të OECD (ang. OECD Mobile basket)




Figura 32: Shporta e tarifave të përdoruesve sipas OECD

Në figurat 33, 34, dhe 35 janë dhëne shportat e tarifave të përdorimit të telefonisë mobile në vendet e Evropës Juglindore.

Tarifat e shportës se ‘përdoruesve të ulët’ në Kosovë gjatë vitit 2011 ka qenë në 5.90 € dhe është nën mesataren e vendeve të Evropës Juglindore e cila sillet rrith në 8.47 €

Shporta e ‘Përdoruesve mesatar’ në Kosovë është 14.60 € mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore 21.28 € dhe shporta mesatare e ‘përdoruesve të lartë’ sillet rrith 27.00 € në Kosovë dhe 39.20 € mesatarja e vendeve tjera të Evropës Juglindore.




Figura 33: Shporta e tarifave për përdorues të ulët (Low sage basket) burimi Cullen internacional




Figura 34: Shporta e tarifave për përdorues mesatar (medium usage basket) burimi Cullen international




Figura 35: Shporta e tarifave për përdorues të lartë (high usage basket) burimi Cullen international

Tarifat e thirrjeve kombëtare

Në figurat 36 dhe 37 janë paraqitur tarifat bazike të thirrjeve me pakice të operatorëve mobil për ‘peak’ dhe ‘off-peak’.




Figura 36: Tarifat e thirrjeve kombëtare për 'peak'




Figura 37: Tarifat e thirrjeve kombëtare për 'off-peak'

Tarifat e thirrjeve ndërkontinentale

Në figurën 38 janë paraqitur tarifat e thirrjeve ndërkontinentale, përkatesisht drejt vendeve të regionit dhe disa shteteve tjera evropiane.




Figura 38: Tarifat e thirrjeve ndërkontinentale

Tarifat e për SMS

Në figurën 39 janë paraqitur tarifat e për dërgimin e SMS kombëtar dhe ndërkontinentale , për të 4 operatoret mobile.




Figura 39: tarifat e dërgimit të SMS -ve

Tarifat e Roamingut

Figurat 40 dhe 41 paraqesin tarifat e origjinimit të thirrjeve kur përdoruesit janë në roaming dhe origjinojnë thirrje roaming, si dhe tarifat e pranimit të thirrjeve kur përdoruesit janë në vendet e përshkruara rajonale dhe më gjërë.




Figura 40: Tarifat e origjinimit të thirrjeve kur përdoruesit janë në roaming dhe origjinojne thirrje roaming





Figura 41: Tarifat e pranimit të thirrjeve në roaming

Tarifat e terminimit

Në figurën 42 janë dhënë tarifat e terminimit të thirrjeve mobile dhe fikse të operatorëve të vendeve të Evropës Juglindore. Nga të dhënat e paraqitura në figure vërehet se tarifat e terminimit të thirrjeve në Kosovë janë në prag të mesatares së vendeve të BE -27 dhe nën mesataren e vendeve të Evropës Juglindore.

Aktualisht tarifat e terminimit të thirrjeve mobile në Kosovë janë 6.3 eurocent për minutë.

Eliminimi i asimetrisë në terminimin e thirrjeve ndërmjet operatorëve mobil në Kosovë dhe caktimi i tarifave konkurruuese, krijon një ambient dhe kushte të favorshme për një konkurrencë efektive në treg.




*Figura 42: MTR në shtetet e Evropës Juglindore dhe BE-27
(Burimi: Cullen internacional, Raporti 2, Maj 2012)*

Nga të dhënat në grafik vërehet se në të gjitha vendet e Evropës juglindore tarifat e terminimit janë të njëjta, gjersë një asimetri e tarifave të terminimit në mes të operatorëve mobil dhe fiks është e pranishme në Kosovës dhe i njëjtë fenomen paraqitet dhe në Serbi por me një diferencë më të vogël.

Në figurën në vijim (fig.43) është paraqitur shkalla e zvogëlimit tarifave të terminimit në shtetet evropiane¹¹, nga data 01 janar 2006 deri me 01 korrik 2010¹².

¹¹ <http://www.erg.eu.int/>

¹² Mesatarja e thjeshtë (ang. Simple average)



*Figura 43: shkalla e zvogëlimit të tarifave të terminimit të thirrjeve mobile në shtetet evropiane
(Burimi: BEREC; MTR Benchmark snapshot 2006, 2007, 2008, 2009, 2010)*

Mesatarja e thjeshtë e terminimeve mobile në Kosovë nga data 12 dhjetor 2007 deri më tani është zvogëluar me një ritëm të kënaqshëm, e që në vitin 2007 (fillim të vitit 2008) kanë qenë nën mesataren e shteteve të BE-së.

Në figurën 44 është paraqitur shkalla e zvogëlimit të MTR në Kosovë nga viti 2008 deri me tani.




Figura 44: Shkalla e zvogëlimit të tarifave të terminimit të thirrjeve mobile në Kosovë

Nga figura 44 vërejmë se trendi i zvogëlimit të MTR është 8.3% në periudhën 12/12/2007 - 01/10/2008 dhe ka vazhduar trendin e zvogëlimit deri në 20.6% në periudhën 01/10/2008-01.04.2009. Ky zvogëlim i MTR në Kosovë na bën të kuptojmë se kemi të bëjmë me një treg i cili prej ditës në ditë po lëviz drejt pjekurisë dhe konkurrencës së shëndoshë duke i lëshuar rruge paraqitjes së ofertave/produkteve të reja nga të cilat përfitues nuk janë vetëm operatorët por edhe konsumatorët.

Mbulueshmëria dhe elementet e rrjetit

Aktualisht mbulueshmëria ka arritur nivelin në rreth 99% të popullsisë në nivel vendi dhe rreth 88% sa i përket territorit. Numri i stacioneve transmetuese për momentin është rreth 721 (BTS). Teknologja që përdoret është EDGE, e cila mundëson ofrimin e shërbimeve të internetit përvèç atyre të zërit dhe shërbimeve MMS (krahas atyre SMS).




Figura 45: Mbulueshmëria e operatorëve mobil

INTERNETI

Numri i përdoruesve me qasje brezë gjerë

Qasja në internet për qytetarët e Republikës së Kosovës ofrohet nga 37 ndërmarrje të licenuara, 5 prej tyre kanë qasje të drejtpërdrejt në daljet ndërkombëtare (Internacional Gateway), dhe u ofrojnë qasje në rrjetin e internetit të ISP-ve më të vogla, të cilët veprojnë në rajone të ndryshme të Kosovës. Gjithashtu, gjatë vitit 2011, shërbimet brez-gjera (broadband) të Internetit vazhdojnë të kenë rritje të numrit të përdoruesve (shih figurën 46).




Figura 46: Numri i përgjithshëm i përdoruesve të internetit

Sipas të dhënave zyrtare më të fundit të raportuara nga operatorët, numri i familjeve që kanë qasje në Internet me brez të gjerë është afersisht 48.55%. Bazuar në këto të dhëna, penetrimi i internetit në vitin 2011 (bazuar në të dhënat e fundit të azhurnuara) për banor rezulton të jetë 8.26%.




Figura 47: Penetrimi i shërbimeve të internetit 2007-TM4-2011

Krahasuar me vendet rajonale, Kosova ka një rritje të kënaqshme të penetrimit të shërbimeve brez-gjera. Në figurën 48, është paraqitur penetrimi i shërbimeve brez-gjera fikse e internetit për banor në shtetet rajonale, dhe mesatarja e shteteve të BE-se.




Figura 48: Penetrimi i shërbimeve brez-gjera fikse të internetit në Shtetet e Evropës Juglindore dhe mesatarja e Vendeve të BE-27 (Burimi: Cullen International, Raporti 2, maj 2012)

)

Ndarja e tregut

Për dallim nga shtetet tjera rjonale dhe me gjerë, shumica e tregut të internetit në Kosovë zotërohet nga operatorët alternativ. Në figurat e mëposhtme (49,50,51 dhe 52) është paraqitur ndarja e tregut për periudhat TM1-2011 dhe TM4-2011. Në TM4-2011 IPKO zotëron rreth 51.21%, PTK/TiK zotëron rreth 25.43%, kurse Kujtesa.net zotëron 19.08% pjesë të tregut bazuar në qasjen e ofruar në këtë shërbim për përdoruesit fundor (shih figurën 72).




Figura 49: Ndarja e tregut të shërbimeve të internetit TM1-2011




Figura 50: Ndarja e tregut të shërbimeve të internetit TM2-2011




Figura 51: Ndarja e tregut të shërbimeve të internetit TM3-2011




Figura 52: Ndarja e tregut të shërbimeve të internetit TM4-2011

Teknologjité e përdorura

Lidhjet e internetit për përdoruesit nëpërmjet modemit kabllor është teknologjia më dominuese me rreth 98.8 mijë përdorues të tillë.

Qasja në internet përmes teknologjisë ADSL deri në fund të vitit 2011 është rreth 36.5 mijë përdorues, nga të cilët rreth 94% janë përdorues individual, kurse pjesa tjerët prej 6% janë përdorues të biznesit.

Të dhënrat e këtij viti për shërbimet e Internetit tregojnë për një rritje të përdoruesve të internetit nëpërmjet ADSL-it, e cila krahasuar vitin paraprak (2010) ka një rritje prej 7.34%.

Teknologja pa tela (wireless) kryesisht dominon në zonat rurale, dhe shfrytëzohen brezet e pa-llicencuara frekuencore 2.5 GHz dhe 5 GHz. Këto shërbime ofrohen nga ofruesit e vegjël të shërbimeve të internetit dhe shpejtësia mesatare është rreth 256 kbps.

Në figurat 54 dhe 55 është paraqitur përqindja e teknologjive të cilat shfrytëzohen.




Figura 53: Shpërndarja e qasjes në internet sipas mënyrës se qasjes – TM4-2011




Figura 54: Shpërndarja e qasjes në internet gjatë viteve 2007- 2011

Përdoruesit sipas operatorëve (ISP)

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat sipas raportimeve të ofruesve të licencuar për shërbimeve të internetit për numrin e përdoruesve me qasje broadband në Internet.

Tabela 8: Numri i përdoruesve me qasje brez-gjerë në Internet (TM1 2010 - TM4 2011)

	TM1 2010	TM2 2010	TM3 2010	TM4 2010	TM1 2011	TM2 2011	TM3 2011	TM4 2011
PTK	32745	34068	35498	35,807	37,105	376,354	37,090	36,432
IPKO	50298	50298	47685	64,861	67,010	68,967	70,003	73,354
Kujtesa	18983	18691	20638	24,202	23,448	24,543	24,793	27,331
Armotion	147	157	150	164	181	189	192	203
Vip Trading	109	264	228	377	351	295	342	520
Ati-Kos	235	260	280	335	355	375	395	415
Elkom F	-	-	-	-	120	106	106	130
Orange NET	-	-	-	-	350	0	0	317
Drinia Net	-	-	-	-	302	313	290	551
Meb Communications	-	-	-	-	215	215	265	305
ITS	-	-	-	-	144	147	138	209
ISP tjerë					3,844	2,641	3,253	3476
TOTALI	103,040	104,365	105,061	126,415	133,425	135,425	136,867	143,243

Nga të dhënat e raportuara vërehet se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve brez-gjera u ofrohet përdoruesve nga operatorët përmes kombinim kabllos koaksiale apo linjë bakri. Teknologjia kryesore vazhdon të jetë modemi kabllor me rreth 67.6%, ndërkaq rreth 27.7% të përdoruesve të internetit ky shërbim iu ofrohet përmes teknologjisë ADSL. Si ofrues kryesor të internetit përmes kabllit koaksal janë IPKO dhe Kujtesa.net ndërsa operator i vetëm i cili e ofron qasjen në internet për përdoruesit fundor përmes teknologjisë ADSL është PTK – TiK.

Tabela 9: Numri i përdoruesve me qasje brez-gjëre në Internet (TM1 2010 - TM4 2011)

Teknologjia e qasjes brezgjëre	TM1 2010	TM2 2010	TM3 2010	TM4 2010	TM1 2011	TM2 2011	TM3 2011	TM4 2011
xDSL	32745	34068	35498	35807	37105	37634	37090	36431
Modem kabllor	65495	65223	64917	83692	89110	91381	92566	98759
Wireless (FWA) 2.4-5.5GHZ	4249	4272	3826	5072	1241	4187	4697	6542
FTTH/B	46	47	45	21	514	542	562	922
Wireless Hot-spot (Wi-Fi)	235	260	280	335	5085	16802	1952	589
Other	270	495	495	1137	370	1	0	0
Totali	103,040	104,365	105,061	126,064	133,425	135,425	136,867	143,243

Gjatë TM4-2011, janë vërejtur ndryshime cilësore në ofrimin e qasjes brez-gjerë në Internet, ku pjesa dërmuese e operatorëve e kanë rritur kapacitetin e çasjes në internet për përdoruesit fundor

deri në 5 herë duke mos i ndërruar çmimet për shërbimet e tilla. Në figurën 56 është paraqitur struktura e përdoruesve të internetit në bazë të kapacitetit.



Figura 55: Struktura e përdoruesve të internetit në bazë të kapacitetit

Tarifat

Shpejtësitet e transmetimit ndryshojnë nga 512kbps deri në 8Mbps, ndërsa në viset rurale ato fillojnë nga 256 kbps (figura 56).

Figura 56 ilustron tarifat mujore të shteteve rajonale për 1Mbps, dhe krahasimi i tyre me Kosovën.




Figura 56: Shpejtësitet dhe tarifat




Figura 57: Tarifat mujore për 1Mbps në valutën euro duke përfshirë TVSH (Burimi:Cullen International, Raporti 4, dhjetor 2010)

LINJAT ME QIRA

Aktualisht operatorët, të cilët ofrojnë linja me qira janë; PTK sh.a, IPKO, Kujtesa.net dhe Konet. Në figurat në vazhdim janë tarifat e linjave me qira për kapacitetin prej 2 Mbps dhe 34 Mbps, për shtetet rajonale dhe me gjerë.




Figura 58: Tarifat për kapacitetin prej 2Mbps në shtetet rajonale (Burimi: CI)




Figura 59: Tarifat për kapacitetin prej 34Mbps në shtetet rajonale (Burimi: CI)

PASQYRË E PËRGJITHSHME MBI TREGUN POSTAR

Detyrat dhe përgjegjësit e ART-së, në fushën e shërbimeve postare janë të definuara në bazë të Ligjit Nr. 03/L-173 për Shërbimet Postare, dhe akteve tjera nënligjore të nxjerrra në bazë të këtij ligji. Në këtë drejtim ART përkatësisht Sektori i Shërbimit Postar ka përmbushur dhe ka realizuar në plotëni synimet dhe objektivat e parapara për vitin 2011, duke u kyqur në mënyrë aktive në rregullimin e tregut të shërbimeve postare dhe në procesin e monitorimit dhe mbikëqyrjes së mbarvajtjes së realizimit të shërbimeve postare.

Deri në fund të vitit 2011, ART në regjistrin e operatorëve postar (<http://www.art-ks.org/?cid=1,159>) ka të evidentuar gjithësejt shtatë (7) operator të cilët ofrojnë shërbime postare në Republikën e Kosovës.

Posta e Kosovës si njësi e veçantë e biznesit brenda PTK Sh.a është operator i vetëm publik i autorizuar të ofroj shërbime universale dhe të rezervuara si dhe shërbime tjera postare në tërë territorin e vendit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe është 100% në pronësi të Qeverisë së Kosovës, ndërsa operator me pronësi private janë gjithsejtë gjashtë (6) të cilët kryesisht operojnë në Prishtinë dhe ofrojnë shërbime korrier dhe ekspresë.

Tabela 10. Regjistri i Licencave të operatorëve të shërbimeve postare.

Nr.	Emri dhe adresa e kompanive	Nr. i Licencës	Data e dhënies së Licencës	Llojet e shërbimeve	Territori	Afati i Licencës
1	PTK SH.A. Dardanis p.n. 10000, Prishtinë	0115052006	15.05.2006	1. Shërbime Ekspres, 2. Faksimile, 3. Shërbime Financiare,	Republika e Kosovës	15.05.2016
2	Salbatring Int. Sh.p.k Sheshi Nëna Terezë 25/b 10000, Prishtinë	0315052006	15.05.2006	1. Shërbime Ekspres, 2. Shërbime Korrier, 3. Import -Ekspart,	Republika e Kosovës	15.05.2016
3	N.T.SH. KCC Sheshi Zahir Pejaziti, 10000, Prishtinë	0415052006	15.05.2006	1. Shërbime Korrier, 2. Shërbime Ekspres Global	Republika e Kosovës	15.05.2016
4	A.L. Dushi Sh.p.k Rr. UÇK-kë nr. 105/1 10000, Prishtinë	0615052006	15.05.2006	1. Ekspres Import - Ekspart, 2. Shërbime Korrier,	Republika e Kosovës	15.05.2016
5	KOEX Sh.p.k. Reshat Karajgëdiu nr. 7 20000, Prizren	02/160309	16.03.2009	1. Shërbime Ekspres, 2. Shërbime Korrier,	Republika e Kosovës	15.03.2019
6	NTP Vlora Komerc Egrem Çabej nr. 137/145 10000, Prishtinë	01/160309	16.03.2009	1. Shërbime Ekspres, 2. Shërbime Korrier,	Republika e Kosovës	15.03.2019
7	N.Sh.T. Express Delivery Service Perand. Dioklician Nr. 11 10000, Prishtinë	01/270810	27.08.2010	1. Shërbime Ekspres, 2. Shërbime Korrier,	Republika e Kosovës	26.08.2020

Gjat vitit 2011 Sektorit i Shërbimit Postar ka nxjerr dy akte nënligjore në përmbushje të detyrimeve të ART-së për rregullimin e fushës së sektorit postar si;

- Aktvendimi për 'Miratimin e tarifave për licencim të operatorëve postar dhe vodosja e tarifës së rregullt vjetore (One-off-fee) për operatorët e Shërbimeve Postare' (Ref. Nr. Prot. 021/B/11, datë; 18/04/2011), i cili përcakton tarifat për dhënien e licencave dhe ka përcaktuar vlerën e taksës së rregullt vjetore (one-off-fee) për operatorët të cilët ofrojnë shërbime postare në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe në bashkëpunim me deaprtamentin e DT-së ka nxjerr
- Rregulloren për të dhënat statistikore periodike të operatorëve të cilët ofrojnë shërbime telekomunikuese dhe postare (Ref. Nr. Prot. 048/B/11, datë 13/09/2011).

Kjo Rregullore ka obliguar të gjithë operatorët e shërbimeve postare që të raportojnë në baza periodike tremujore pranë ART-së të dhënat e specifikuara sipas kërkesës së paraqitur në pyetësor. ART, për herë të parë ka filluar të pranoj të dhënat statistikore mbi volumin e dërgesave postare të dhënat mbi kapacitetet teknike dhe teknologjike, të dhënat mbi pasqyrat e të hyrave të operatorëve postar, të dhënat për ankesa dhe reklamacione të shfrytëzuesve/konsumatorëve, numrin e të punësuarve etj.

Grafiku në vazhdim tregon të dhanat sipas % për volumin e dërgesave postare në total për TM3 dh TM4 2011.




Figura 60. Ndarja e tregut të volumit të dërgesava sipas operatorëve për periudhën TM3 & TM4 viti 2011

Grafiku në vazhdim ilustron volumin e dërgesave të ndara sipas kategorive në trafikun e brendshëm dhe ndërkombëtar të realizuar nga Posta e Kosovës.




Figura 61: Volumi i dërgesava i ndarë sipas kategorisë së dërgesave dhe trafikut për periudhën TM3 dhe TM4 të vitit 2011 I realizuar nga Posta e Kosovës

Meqenëse këto të dhëna janë pranuar për gjashtëmujorin e dytë, ART ka arritur të nxjerr një pasqyrë të saktë të volumit të dërgesave postare për TM3 dhe TM4 të vitit 2011 për të gjithë operatorët dhe në veqanti për Postën e Kosovës, ndërsa ART ka pranuar raportet mbi pasqyrat financiare të operatorëve postar për gjithë vitin 2011 e cilat në total kap vlerën / shumën prej 3,212,770.60 €.

Grafiku në vazhdim pasqyron ndarjen e tregut të shërbimeve postare sipas të hyrave të operatorit publik dhe operatorëve privat.




Figura 62: Paraqitura grafike e ndarjes së tregut te operatorit Publik dhe operatorve privat sipas të hyrave për vitin 2011

Grafiku në vazhdim pasqyron krahasimin e të dhënavëve mbi tregut të shërbimeve postare të ndarë për secilin operator në bazë të pasqyrave financiare të deklaruara për vitin 2011.




Figura 63. Paraqitura grafike e ndarje së tregut te operatorëve postar sipas të hyrave për vitin 2011

Tregu i shërbimeve postare në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2011 ka shënuar një rritje të lehtë dhe atë të shprehur kryesisht tek operatorët privat postar ndërsa Posta e Kosovës si operator publik ka pasur një rënje prej 1,7 % në të hyrat e përgjithshme krahasuar me vitin paraprak.

Grafiku në vazhdim pasqyron kahasimin e të dhënave dhe lëvizjen/ndryshimet e të hyrave të Postës së Kosovës për tri vite e kaluara.




Figura 64. Paraqitura grafike dhe lëvizja sipas të hyrava të Postës së Kosovës për tre vite.

Sektori i Shërbimit Postar gjat vitit 2011, me qëllim të mbikqyrjes së mbarëvajatjes së realizimit të shërbimeve postare ka realizuar kontolle dhe inspektime të ndryshme duke mbuluar me aktivitetet e saj;

- 25 pika/zyra postare, të operatorit publik postar, Posta e Kosovës të shpërndara në tërë territorin e vendit, dhe
- 8 pika/zyra të operatorëve privat postar dhe agent të tyre të vendosur/shpërmdarë nëpër qendrat të ndryshme të vendit.

Gjatë këtij procesi janë inspektuar/kontrolluar dokumentet e ndryshme të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të shërbimit postar, përfshirë librat e evidentimit/pranimit të dergesave, çmimoret/tarifat e realizimit të shërbimeve përkatësisht aplikimi/përdorimi i tyre, kushtet e ofrimit të shërbimeve, regjistrimi/evidencimi i reklamacioneve/ankesave të shfrytëzuesve - zbërthimi i tyre, standardet e cilësisë së realizimit të shërbimit, transparenca dhe informimi i shfrytëzuesve/konsumatorëve lidhur me shërbimet dhe tarifat e shërbimeve postare etj.

Pas përfundimit të këtij procesi Sektori i Shërbimit Postar ka paraqitur një raport të përgjithshëm dhe në rastet në të cilat është konstatuar se ka lëshime të natyrave të ndryshme, zyrtarët e ART-së kanë dhënë udhëzimet dhe rekomandimet e nevojshme në gjetjet e konstatuara, me qëllim të ngritjes së nivelit të cilësisë së shërbimeve.

Veprimitaria juridike e ART-së në rregullim

Veprimitaria juridike e ART gjatë vitit 2011, kryesisht ka konsistuar në;

- a) Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve telekomunikuese;
 - b) Inicimin e procedurave gjyqësore për përmbarimin e detyrimeve të palëve ndaj ART-së;
 - c) Pjesëmarrjen si palë e paditur apo palë e tretë në procese gjyqësore; dhe
 - d) Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit.
- a) Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve të telekomunikacionit**

Rritja e numrit të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve telekomunikuese mes tjerash, ka sjell si rezultat edhe rritjen e numrit të mos-marreveshjeve ndërmjet tyre. Në bazë të dispozitave të Rregullores për Procedurat e Zgjidhjes së Konflikteve Nr. 183/07, ART ka ushtruar kompetencat e sajë në zgjidhjen e tri (3) mos-marrëveshjeve ndërmjet operatorëve nëpermjet udhëheqjes së rasteve në të gjitha stendet e një procedimi administrativ.

Shembull:

Kontesti mbi çështjen për 'Ndërprerjen e njëanshme të marrëveshjes (kontratës) komerciale për Qiradhënien e Fijeve Optike'

Për më shumë mbi kontestin nga linku në vijim <http://www.art-ks.org/?cid=1,26,335>, mund të shkarkohet vendimi i komisionit funksional për arbitrimin të kontestit i cili ngërthen diapozitivin e aktvendimit, pjesën e arsyetimit dhe rrethanave të kontestit si dhe bazën ligjore të referuar në zgjidhje të këtij kontesti.

- b) Inicimin e procedurave gjyqësore për përmbarimin e detyrimeve të palëve ndaj ART-së**

Gjatë vitit 2011 ART ka iniciuar procedurat gjyqësore per përmbarimin e detyrimeve pranë gjykatave kompetente ndaj katër (4) debitorëve dhe gjitha këto procedura ende janë në procedurë e sipër.

Shembull:

Lenda e parashtrimit te propozimit për ekzekutim kundër operatorit/debitorit 'Call Center Kosova' për pagimin e borxhit (*pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut, dt. 21/06/2011 - lënda në procedurë e sipër*).

- c) Pjesëmarrja në procese gjyqësore**

Gjatë vitit 2011, ART ka qenë e përfshirë në gjithsej 2 procese gjyquesore ndër të cilat;

- një (1) çështje ART ka qenë palë paditëse në procedurë të konflikti administrativ pranë Gjykatës Supreme, dhe

- një (1) çështje ART është ftuar në cilësinë (kapacitetin) e caktimit të ekspertëve në kontestin mes operatorëve që kanë zgjedhur udhëheqjen e kontestit të tyre pranë Gjykatës Kompetente (GJEQ).

Gjithashtu gjatë vitit 2011 ndaj ART-së janë iniciuar procedurat gjyqësore përmbi propozimet përekzekutim për shlyerje të borxhit nga kreditori PTK Sh.a (lëndët në procedurë e sipër të kontestuara nga ART).

d) Mbrojta e të drejtave të konsumatorit

Aktivitetet rregulatorore të ART-së mes tjerash shërbejnë edhe për të arritur dhe jetësuar parimet rregulatorore dhe objektivat e ndërlidhura me përdoruesit e shërbimeve telekomunikuese dhe postare në mënyrë që konsumatorët, përmes inkurajimit të konkurrencës efektive, të sigurohen përfitimet sa më të mira të mundshme për shfrytëzuesit e shërbimeve në aspektin e çmimeve, të përzgjedhjes dhe cilësisë së shërbimeve.

Promovimi i interesave të përdoruesve arrihet në mënyrë të veçantë me anë të procedurave të mëposhtme;

- sigurimit të qasjes në shërbimet telekomunikuese dhe postare për të gjithë përdoruesit,
- siguruar qasje të lehtë dhe garantuar dhe procedura të thjeshta për zgjidhjen e kontesteve në mes operatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve;
- nxitjen dhe promovimin e informacioneve të qarta, në veçanti ndërlidhur me transparencën e çmimeve dhe kushtet për përdorimin e shërbimeve publikisht në dispozicion;
- siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë; dhe angazhuar në
- krijimin e parakushteve për sigurimin e qasjes dhe shërbimeve të përshtatshme për nevojat e grupeve të veçanta shoqërore, në mënyrë të veçantë referuar përdoruesve me aftësi të kufizuara.

Gjatë vitit 2011, ART ka pranuar pesë raste të kualifikueshme të ankesave të konsumatorëve, të cilat janë trajtuar nga stafi profesional i ART-së. Pas shqyrimit të ankesave janë marrë vendime dhe janë dhënë rekomandime dhe instruksione për zbatimin e të drejtave të konsumatoreve në veçanti dhe zbatimin e Ligjit në përgjithësi.

Për qëllime këtij raporti, paraqesim për ilustrim një prej udhëzimeve të dhëna për njërin nga operatoret e rrjetit, ku i njëjtë është obliguar nga ART të mundësoj identifikimin e thirrësit në numrin e alokuar për Policinë e Kosovës, lidhur me raportimin e substancave narkotike.

Veprimtaria inspektuese dhe monitoruese

Veprimtaria inspektuese

Ushtrimi i veprimtarise inspektuese ne vitin 2011, për herët të parë nga themelimi i ART-së është filluar së zbatuari bazuar në metodologjinë e;

- inspektimet me karakter të përgjithshëm dhe
- inspektimet me tematike specifike.

Inspektimet me karakter të përgjithshëm, janë ato inspektimet të cilat udhëhiqen në kuadër të mbikëqyrjes së ushtrimit të veprimtarisë së autorizuar nga ana e operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve telekomunikuese si dhe operatorëve të shërbimeve postare në përpunje me kushtet e licencave dhe autorizimeve të lëshuara nga ana e ART-së.

Veprimtaria inspektuese gjatë vitit 2011, ka qenë pakrahasueshmërisht në nivel shumë më të lartë se viti 2010, jo vetëm nga numri i inspektimeve të kryera perkatesisht 106 sosh, kundrejt 57, por edhe nga evidentimi i përmiresimeve që duhet të ndodhin në kuadrin ligjor dhe atë nënligjor. Për sa më siper, në fund të vitit 2011 u hartua dhe u aprovua rregullorja për inspektimet e zhvilluara nga ART.

Veprimtaria monitoruese

Sektori i radio-monitorimit të spektrit radio-frekuencor, gjatë vitit 2011, ka ushtruar veprimtarinë bazuar në planet e zhvilluara në nivel të DMF-së dhe si të tilla të njohura edhe nga Bordi Drejtues i ART-së.

Për realizimin e matjeve dhe kontrollin e spektrit frekuencor ky sektor disponon me dy sisteme mobile matëse (MMS1 dhe MMS2) të vendosura në dy automjete transportuese që mundësojnë matje në diapazonin frekuencor nga 100 kHz deri ne 26 GHz. Gjithashtu në procesin e matjeve shfrytëzohen edhe pajisjet e tjera matëse të dorës (portable) ndër të cilat më të rëndesishmet janë pajisjet;

- TSMQ - Drive test Tool - për matje e kualitetit dhe mbulueshmerisë me sinjal në brezët frekuencore 900 dhe 1800 MHz për shërbimet e telefonisë mobile dhe
- EB 200 - për matje në brezin nga 20 MHz - 3 GHz për të gjitha shërbimet në këto breze.

Veprimtaria monitoruese ka konsistuar në;

- kontrollin dhe monitorimin e operatorëve shfrytëzues të spektrit frekuencor në përbushje të kushteve të licencave dhe autorizimeve përkatëse si dhe në identifikimin dhe eleminimin e interferencave të transmetimeve radio-komunikuese.
- **Monitorimin e shërbimeve të telefonisë mobile** të operatorëve të licencuar; PTK sh.a./VALA dhe IPKO Telecommunications LLC në brezët frekuencore GSM 900 dhe 1800 MHz përgjatë tërë territorit të Republikës së Kosovës, me theks të veçantë përgjatë rrugeve (akseve) nacionale.

- **Monitorimin e brezeve frekuencore në zonat kufitare të operatorëve të telefonisë mobile** të shteteve fqinje (Republikës së Maqedonisë, Republikës së Malit të Zi, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Sërbisë) sinjali i të cilëve depërton në territorin tonë duke tejkaluar parametrat teknik e bazuara në rekomandimet ndërkombëtare që rregullojnë shfrytëzimin e frekuencave në zonat (brezet) kufitare.
- **Kontrollin dhe monitorimin e shërbime PMR** në brezet frekuencore VHF dhe UHF në tërë territorin e Republikës së Kosovës për verifikimin e shfrytëzimit të spektrit frekuencor nga subjektet e rinj dhe ata ekzistues me qëllim të pajisjes me autorizime individuale për përdorim të frekuencave si dhe ata që kanë deklaruar ndërprerjen e aktivitetit, duke mundësuar në këtë mënyrë edhe përditësimin e bazës së të dhënave të disponuar dhe administruar nga ART.
- **Verifikimin e ankesave të subjekteve përmbi interferencat** – gjithsej 5 raste të pranuara dhe si të tillë të trajtuara;
- **Kontrollin e brezit dhe kanaleve frekencore (SHF > 3 GHz)**, verifikimi i përbushjes së kushteve të licencës për shërbime fikse, të linjave mikrovalore pikë-pikë PTP për operatorët e licencuar. Shërbimet fikse mikrovalore rezultojnë me shfrytëzueshmëri të lartë të spektrit frekuncor nga operatorët shfrytëzues të shërbimeve telekomunikuese si; PTK sh.a/VALA, IPKO, Kujtesa.net, Artmotion, Policia e Kosovës, MAP, OSCE, EULEX, etj)
- **Kontrollin dhe monitorimin e brezeve frekuencore për shërbime të aeronautikës dhe shërbimeve TETRA**, identifikimi dhe eliminimi i interferencave të shkaktuara në këto breze nga operatorë vendor të shërbimeve radio-difuzive dhe të tjera që kanë interferuar në shërbimet telekomunikuese edhe në shtetin fqinjë të Republikës së Maqedonisë, rast ky i zgjidhur me sukses dhe koordinim me autoritetin homolog të Republikës së Maqedonise.
- **Monitorimin dhe verifikimin e kushteve të licencës** të operatorëve që ofrojnë shërbimet satelitore - VSAT

LLOGARIDHËNIA E ART-së

Sigurimi i integritetit

Bordi i Autoritetit Rregulator të Telekomunikacionit, përmes kësaj deklarate siguron Kuvendin e Republikës së Kosovës, tek i cili Autoriteti Rregulator i Telekomunikacionit raporton, se informacionet e paraqitura në Raportin Vjetor për vitin 2011, përfshi këtu Pasqyrat Financiare, janë të sakta, të besueshme dhe objektive.

Deklarata për Transparencë

Me këtë ne ju sigurojmë se veprimtaria jonë gjatë vittit 2011 është zhvilluar në përputhje me dispozitat e Ligjeve burimore, politikave të sektorit të telekomunikacionit, kornizës rregullatore dhe rregullores së brendshme të ART-së.

ANEKS A
Plani i Punës 2011

OBJEKTIVI-AT		AKTIVITETI-ET	AUTORITETI PËRGJEGJËS	AFATI-ET
1	Krijojë kushte për zhvillimin e mëtejshëm të telekomunikacioneve dhe të shoqërisë së informacionit	1.1 Implementimi i Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit	ART	Në Kontinuitet
		1.2 Mbështes dhe inkurajoj adoptimin e politikave të reja dhe strategisë për zhvillimin e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës në periudhën 2011-2013	QeK / MTPT / ART	Në Kontinuitet
2	Liberalizimi i sektorit të Telekomunikacionit	2.1 Autorizimi/Licencimi në pajtim me ligjin e Telekomunikacionit dhe rregullat e aplikueshme të parashikuara me legjislacionin sekondarë	ART	Në Kontinuitet
		2.2 Ri-definimi i kategorive ekzistuese te licencave ne funksion te lehtësimit te hyrjes se ofruesve te shërbimeve/operatorëve të shërbimeve telekomunikuese dhe evitimit të barrierave për hyrje te reja ne tregun e telekomunikimeve	ART	Kuartali I /2011
3	Caktimi i brezit 1800 MHz operatorit PTK sh.a./Vala	3.1 Përmbyllja e procedurave të nevojshme administrative të dhënes në shfrytëzim të brezit 1800 MHz, sipas dispozitave të 'letër qëndrimit të ART	ART	Kuartali I /2011
		3.2 Prezantimi i raportit të vlerësimit/rekomandimit në vlerën e brezit për QeK për përcaktimin e pragut minimal	QeK / ART	Kuartali I /2011
4	Përfundimi e Analizës së Tregut (Tregjet dhe nen-tregjet e Telefonisë Fiksë)	4.1 Themelimi i grupit të ekspertëve për të drejtuar dhe implementuar analizën e tregut	ART	Kuartali I /2011
		4.2 Publikimi i vendimit për fillimin e procesit të analizës	ART	Kuartali I /2011
5	Caktoj dhe filloj me implementimin e obligimeve ndaj ONT-së (SMP-së)	5.1 Përfundimi i studimit dhe publikimi në procesin e rregullt të konsultimit publik	ART	Kuartali IV /2011
		5.2 Publikimi i vendimeve	ART	Kuartali IV /2011≥
6	Krijimi i komizës ligjore për Shërbimeve Universale	6.1 Pasqyrimi i disponushmërisë së shërbimit	ART	Kuartali III /2011
		6.2 Paraqitura në procedurat e Këshillimit Publik për grupin e parë dhe volumin fillestarë të shërbimeve që do të përfshihen në Shërbime Universale	ART	Kuartali III /2011
		6.3 Përcaktimi i kushteve për grupin e parë dhe volumin fillestar të shërbimeve të përfshira në ofrimin e Shërbimit-eve Universale	MTPT & ART	Kuartali IV /2011
		6.4 Përcaktimi i operatorit-eve me obligimet e ofrimit të shërbimeve Universale	ART	Kuartali IV /2011
		6.5 Inicimi i themelimit te fondit të kompensimit për ofrimin e Shërbimeve Universale	ART	Kuartali IV /2011≥
7	Krijimi i kushteve për zhvillim më të shpejt të infrastrukturës së Telekomunikacionit	7.1 Avancimi dhe plotësimi i kornizave rregullatore që synojnë forcimin e liberalizimit të vazhdueshëm dhe të plotë si dhe mundësojnë krijimin e një ambienti të hapur dhe konkurrent me qëllim të tërheqjes së investitorëve të huaj dhe përmirësimit ët kualiteti të shërbimeve duke siguruar aplikimin e standardeve referente, zhvillimin e infrastrukturës së telekomunikacionit dhe mbrojtjen e ambientit.	ART	Kuartali III /2011
		7.2 Inicimi dhe stimulimi i investimeve vendore dhe të huaja në infrastrukturën telekomunikuese	ART	Kuartali II /2011

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit - Raporti Vjetor për vitin 2011

	OBJEKTIVI-AT		AKTIVITETI-ET	AUTORITETI PËRGJEGJËS ART	AFATI-ET
8	Krijimi i kushteve për zhvillim më të shpejt qasjes brezgjera (broadband access)	8.1	Hartimi i Kornizës rregulatore për zhvillimin të qasjes brezgjerë në Republikën e Kosovës		Kuartali II / 2011
		8.2	Jetësimi i synimeve të kornizës rregulatore për zhvillimin e qasjes brezgjerë në Republikën e Kosovës	ART	Kuartali III /2011>
9	Angazhimi në sigurimin e kodeve/prefikseve shtetëror për shërbimet e telekomunikacionit	9.1	Paraqitja e dokumentacionit relevant pranë institucioneve ndërkombëtare për Kodin e Telefonisë	ART /QeK/MTPT	Në Kontinuitet
		9.2	Paraqitja e dokumentacionit relevant pranë institucioneve ndërkombëtare për Kodin Top Nivelin e Domenit Kombëtar për Shërbimet e Internetit (ccTLD)	ART	Në Kontinuitet
		9.3	Krijimi i kornizës ligjore për Shërbimet Radioamatore	ART	Në Kontinuitet
		9.4	Paraqitja e dokumentacionit relevant pranë institucioneve ndërkombëtare për shenjen Thirrëse për Shërbimet Radio-amatore dhe aeronautike (Call Sign)	ART	Në Kontinuitet
		9.5	Paraqitja e dokumentacionit relevant pranë institucioneve ndërkombëtare për Kodin Shtetëror Postar	ART	Në Kontinuitet
10	Menaxhimi efikas dhe racional i spektrit të radio - frekuencor	10.1	Aprovimi në Kuvendin e Rep. se Kosovës te Tabelës së Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Frekuencor	ART / Kuvendi	Kuartali II /2011
		10.2	Planifikimi Frekuencor ne pajtueshmëri me Tabelën e Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Frekuencor	ART	Kuartali II /2011
		10.3	Definomi i bezeve për dhënien në shfrytëzim për shërbimet telekomunikuese ne përputhje me Tabelën e Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Frekuencor	ART	Kuartali II /2011
11	Avancimi dhe shfrytëzimi racional i Planit të Numeracionit	11.1	Harmonizimi i shfrytëzimit të resurseve numerike në pajtueshmëri me Planin e Numeracionit	ART	Në Kontinuitet
12	Shfrytëzimi efikas i infrastrukturës Telekomunikuese	12.1	Aplikimi i masave irregulatore për promovimin e bashkë-shfrytëzimit te infrastrukturës te telekomunikacionit	ART & MTPT	Kuartali III /2011
		12.2	Mbëshetja e rismave dle iniciativave nga sektori publik dhe privat në jetësimin e synimeve nationale për infrastrukturë dhe shërbime adekuate telekomunikuese në institucionet edukative ne të gjitha nivelet ne mbare territorin e Republikës së Kosovës.	QeK & ART & MTPT	Në Kontinuitet
		12.3	Funksionalizimi i Nyjës Shkëmbyeze për trafikun e internetit kombëtar	ART & ISP Operatoret	Kuartali II /2011
